

University for Business and Technology in Kosovo

## UBT Knowledge Center

---

Theses and Dissertations

Student Work

---

2009

### “Sistemi tatimor dhe tatimi në të ardhura personale në Kosovë”

Samire Pireva

*University for Business and Technology - UBT*

Follow this and additional works at: <https://knowledgecenter.ubt-uni.net/etd>



Part of the [Business Commons](#)

---

#### Recommended Citation

Pireva, Samire, “Sistemi tatimor dhe tatimi në të ardhura personale në Kosovë” (2009). *Theses and Dissertations*. 2538.

<https://knowledgecenter.ubt-uni.net/etd/2538>

This Thesis is brought to you for free and open access by the Student Work at UBT Knowledge Center. It has been accepted for inclusion in Theses and Dissertations by an authorized administrator of UBT Knowledge Center. For more information, please contact [knowledge.center@ubt-uni.net](mailto:knowledge.center@ubt-uni.net).

*University for Business and Technology*



Fakulteti për Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi

Temë Diplome

Viti akademik 2006/2007

SAMIRE PIREVA

(2006070126/B)

**“Sistemi tatimor dhe tatimi në të ardhura personale në Kosovë”**

Nën mbikëqyrjen e:

Prof. Behxhet Brajshori

Prishtinë, 2009

Përgatitur për shkallën Bachelor

## **Akronimet dhe shkurtesat**

<b>AQF</b>	-	<b>Autoritetin Qendror Fiskal</b>
<b>ATK</b>	-	<b>Administrata Tatimore e Kosovës</b>
<b>BE</b>	-	<b>Bashkimi European</b>
<b>BQK</b>	-	<b>Banka Qendrore e Republikës së Kosovës</b>
<b>MEF</b>	-	<b>Ministria e Ekonomisë dhe Financave - <i>MFE</i></b>
<b>TVSH</b>	-	<b>Tatimi në vlerën e shtuar</b>
<b>PBB</b>	-	<b>Produktin e brendshëm bruto</b>
<b>OECD</b>	-	<b>Organisation for Economic Co-operation and Development</b>
<b>UNMIK</b>	-	<b>United Nations Mission in Kosova</b>

# **PËRMBAJTJA**

Akronimet dhe

shkurtesat.....2

Apstrakti.....7

## ***Kapitulli 1***

1.Hyrje.....8

2. Politika fiskale dhe roli i saj në zhvillimin ekonomik.....10

2.1. Politika fiskale dhe roli i zhvillimit të saj.....10

2.2. Objektivat e politikës fiskale.....12

2.3. Roli i politikës fiskale në politikën ekonomike.....13

2.4. Efektet e politikës fiskale.....16

2.5. Problemet metodologjike të matjes së efekteve stabilizuese të politikës fiskale.17

2.6. Politika fiskale në Kosovë.....18

## ***Kapitulli 2***

3. Sistemi tatimor dhe ndërtimi i tij.....21

3.1. Domethënia e tatimve.....21

3.2. Sistemi tatimor.....24

3.3. Disavantazhet e sistemit tatiomor të komplikuar.....26

3.4. Struktura e sitemit tatimor në Bashkimin European BE.....26

### ***Kapitulli 3***

4. Zhvillimi i sistemit tatimor funksionar në Kosovë në periudhën e pasë luftës.. .....	27
4.1. Sistemi tatimore në Kosovë.....	27
4.2. Ndërtimi i sistemit tatimor në Kosovë.....	29

### ***Kapitulli 4***

5. Tatimi në të ardhura dhe llojet e tij.....	31
5.1 Tatimi në të ardhura.....	31
5.2. Struktura e tatimeve në të ardhurat në Kosovë.....	32
5.3. Tatimi në të ardhurat personale.....	33
5.3.1. Tatimi në paga ( të ardhurat nga pagat) .....	35
5.3.2.1. Kontributet pensionale për të punësuarit Rreg.2001/35.....	36
5.3.2.2. Kontributet pensionale për të vetëpunësuarit.....	36
5.3.3.1. Të ardhurat nga aktivitetet biznesore.....	37
5.3.3.2. Të ardhurat nga aktivitetet biznesore (Bizneset individuale) .....	37
5.3.4. Tatimi i mbajtur ne burim mbi interes.....	38
5.3.5. Tatimi i mbajtur ne burim mbi dividendë.....	38
5.3.5. Pagesa e tatimit për qiratë.....	39
5.3.6. Tatimi i mbajtur në burim mbi fitimet nga lotaria dhe lojrat e fatit.....	39
5.4. Të ardhura të perjashtuara nga tatimi mbi të ardhurat personale.....	40
5.5.1. Shpenzimet e lejuara si të zbritshme nga aktivitetet biznesore.....	40
5.5.2. Shpenzimet pjesërisht të lejuara si të zbritshme.....	40

5.5.3. Shpenzimet në pasuri themelore.....	41
5.5.4. Shpenzimet e pa zbritshme nga aktivitetet biznesore.....	41
5.6.1. Obligimet për të mbajtur libra dhe regjistrime.....	41
5.6.2. Obligimet e mbajtësve të tatimit në burim.....	42
5.7. Deklarata tatimore vjetore.....	42

## ***Kapitulli 5***

6. Të hyrat buxhetore nga fitimi në të ardhura (2003 përfshirë dhe reformat e fundit të 2009).....	43
6.1. Struktura e të hyrave nga Administrata Tatimore në gjashtëmujorin e 2009.....	44
6.2. Krahasimi i normave tatimore ndërmjet vendeve të rajonit.....	46
6.2.1. Tatimi mbi të ardhura në Shqipëri.....	46
6.2.2. Tatimi mbi të ardhura në Mal të Zi.....	47
6.2.3. Tatimi mbi të ardhura në Serbi.....	47
6.2.4. Tatimi mbi të ardhura në Maqedoni.....	47
7. Metodologjia.....	49
8. Analiza e të dhënave.....	50
8.1. Tatimet e larta në të ardhura në nivelin e standardit të të ardhurave në Kosovë zvogëlojnë fuqinë blerëse.....	51
8.2. Reformat e fundit në sistemin tatimor rezultojnë të jenë më favorizuese tek bizneset.....	52
9. Përfundimi.....	53
10. Konkluzat.....	54

11.Referencat.....	56
12. Shtojc 1.....	59
13. Shtojca 2.....	61

## **Tabelat**

Tabela. 1.0. Krahasimi nga viti 2002 dhe deri më 2008 e pjesmarrjes së përqindjes së tatimit në të ardhura personale në të hyrat e buxhetit të Kosoves .....	43
--	----

Tabela 1.2 Paraqet ndrrimin e normave tatimore në të ardhura personale.....	44
---	----

Tabela 1.3 Paraqet tatimin në të ardhura personale në sistemin tatimor në Shqipëri, me bazat tatimore dhe noramt progresive tatimore.....	46
---	----

Tabela 1.4. Paraqet tatimin në të ardhura personale të sistemit tatimor në Malin e zi.....	47
--	----

## **Grafiket**

Grafiku 1.0. Paraqet përqindjet e të hyrave të gjasht mujorit të 2009 nga tatimet në Kosovë.....	45
--	----

## Apstrakti

Qëllimi i këtij studimi është që ne të kuptojmë rëndësinë dhe rolin e sistemit tatimor, në mënyrë më të detajizuar, ndërtimin e sistemit tatimor në periudhën e pasluftës dhe tatimin në të ardhura personale në Kosovë. Gjithashtu vlen të përmendet se ky punim është fokusuar në ndikimin e politikës fiskale me qëllim të nxitjes së investimeve, që është më se e nevojshme për Kosovën në këtë periudhë të tranzicionit. Rëndësi të madhe i kushtohet zhvillimit të sistemit tatimor me aplikimin e normave tatimore dhe ndikimi i reformave të reja të këtij viti 2009, në bizneset afariste. Ky punim është i pasur me një literaturë vendore dhe të huaj, si dhe për realizimin në mënyrë më të efektshëm dhe aktual. Për këtë studim janë bërë intervistat me pyetësor si një instrument ndihmës për të vënë në pah më tepër rolin dhe rëndësinë e sistemit tatimor në përgjithësi në zhvillimin ekonomik të vendit.



## ***Kapitulli 1***

### **1. HYRJE**

*Tatimet, në fund të fundit, janë shumë për t'u paguar, që ne të paguajmë për privilegjin e anëtarësisimit në një shoqëri të organizuar " (Roosevelt, 2007)<sup>1</sup> si dhe "Mua më pëlqen të paguaj tatim. Me të blej qytetërimin " shprehur një mendimi të ngjashëm ( Holmes, 2007)<sup>2</sup> .*

Qëllimi i këtij studim rasti është që të kuptojmë rëndësinë dhe rolin e sistemit tatimor, në mënyrë më të detajizuar ndërtimin e sistemit tatimor në periudhën e pasluftës dhe tatimin në të ardhura personale në Kosovë. Në këtë fazë të hulumtimit të sistemit tatimor në periudhën e pasluftës dhe tatimit në të ardhura personale në Kosovë në mënyrë të përgjithshme do të definohen sfidat dhe problemet në zbatimin e tyre dhe në aplikimin e reformave në normat tatimore të vitit 2009.

Të gjithë ne jemi dëshmitar të trendit të vazhdueshëm të rritjes së zhvillimit ekonomik, por që dallon nga shteti në shtet për nga arritja e zhvillimit ekonomik të vendit me ndihmën e politikës ekonomike, si një proces zingjiror i cili ka për qëllim që i tërë shteti të jetë kontribues në ndërtimin dhe zhvillimin e tij nga individët me status shtetas deri tek organet qeveritare - qendrore. Mirëpo studimi vë në pah rolin dhe funksionin e një shteti që paraprihet nga zivillimi efikas i një politike ekonomike të mirëfilltë, ku si bartëse dhe rregulluese të saj janë organet qeveritare -qendrore dhe lokale që ndikojnë në zgjedhjen dhe realizimin e qëllimeve të saj dhe në një mënyrë këto organe kanë rolin e indikatorëve në rregullimin dhe drejtimin e procesit ekonomik<sup>3</sup>. Ndërsa si veçori themelore të këtyre bartësve të politikës ekonomike janë: definimi i interesit, aftësia vendimmarrëse, aftësia e

---

<sup>1</sup> Roosevelt, F (2007) <http://www.quotegarden.com/taxes.html>

<sup>2</sup> Holmes, O (2007) <http://www.governmentisgood.com/articles.php?aid=17>

<sup>3</sup> Komoni S, (2008). Financat Publike. Fq, 16

veprimit dhe pavarësia e veprimit <sup>4</sup>. Njëra ndër komponentet më të rëndësishme të politikës ekonomike është politika fiskale, e cila e drejton apo menaxhon tërë sistemin tatimor të një shteti <sup>5</sup>.

Nëse analizojmë zhvillimin ekonomik në Kosovë në periudhën e pasluftës, studimi vë në dukje rrjedhat e politikës ekonomike si dhe ndërhyrjen e shtetit përmes politikës fiskale që arsyetohet me veprimet e bëra në drejtim të mënjanimin të dukurive që bëhen pengesë në ruajtjen e mirëqenies së përgjithshme të shoqërisë. Këto dukuri lidhen me veprimin joperfekt të tregut në mbrojtjen e shtresave të varfëra të shoqërisë, krijimin e vendeve të punës, menjanimin e monopoleve dhe rritjen e konkurrencës së mirëfilltë, rishpërndarjen më të drejtë të pasurisë, etj.

Sipas politikës fiskale sistemi tatimor në Kosovë ndikon relativisht në bazë të interesave të shtetit<sup>6</sup>, që është e njëjtë dhe në politikat fiskale të shteteve anëtare të Bashkimit Europian BE duke synuar grumbullimin e të hyrave për mbushjen e arkës së shtetit me qëllim të mbulimit të të dalave (shpenzimeve) qeveritare, si konsumuese kryesore e tatimeve<sup>7</sup>. Megjithatë përshtatshmëria e sistemit tatimor është e nevojshme që të jetë në harmoni me sistemet tatimore dhe sa më afër politikave dhe legjislacionit fiskal të shteteve të Bashkimit Europian, veçanërisht me shtetet e regjionit dhe me shtetet që për Kosovën kanë rëndësi të veçantë. Ndërsa për nga numri i tatimeve, Kosova sot ka sistem të thjeshtë tatimor dhe aplikon këto lloje të tatimeve siç janë: tatimet në të ardhura, në pronë, tatimi në fitim dhe tatimi mbi vlerën e shtuar TVSH, mirëpo në të ardhmen parashikohet sistemi tatimor të jetë më i zgjëruar në masën më të madhe, si dhe do të jetë burimi kryesor i financimit të nevojave publike<sup>8</sup>.

---

<sup>4</sup> Brajshori, B. (2008). Taxation Ligjerate autorizuar

<sup>5</sup> Annett, A (2006) Enforcement and the Stability and Growth Pact: How Fiscal Policy Did and Did Not Change Under Europe's Fiscal Framework. Fq. 13

<sup>6</sup> Komoni S, (2008). Financat Publike. Fq.16

<sup>7</sup> Hallett, A. Hagen, J. Lewis, J (2003). Fiscal policy in Europe, Fq. 29

<sup>8</sup> ATK, Doracak mbi tatimet në Kosovë, 2007 fq. 9

## **2. POLITIKA FISKALE DHE ROLI I SAJ NË ZHVILLIMIN EKONOMIK**

### **2.1. Politika fiskale dhe roli i zhvillimit të saj**

Çka nënkuptojmë me termin politikë fiskale?

Me termin politikë fiskale nënkuptojmë mënyrën se si qeveria zgjedh të shpenzojë buxhetin e saj me qëllim të furnizimit të qytetarëve me shërbime dhe mallra publike. Këto mallra dhe shërbime përfshijnë; infrastrukturën publike, edukimin, shëndetësinë, sigurinë publike, gjyqësinë etj. Qeveria përpiket t'i gjejë metodat më të mira për financimin e këtyre shpenzimeve nëpërmjet llojeve të ndryshme të tatimeve si: TVSH, taksat doganore, tatimet në të hyra personale, tatime në të hyra të korporatave, kontributet për sigurimin social, etj. Gjatë zbatimit të politikave tatimore, qeveria mundohet që të sigurojë nivel të ulët të ngarkesave tatimore dhe trajtim të barabartë si për biznese, ashtu dhe për qytetarë <sup>9</sup>.

Megjithëatë shpenzimet dhe taksat e shtetit ndikojnë drejtpërdrejtë në performansat e përgjithshme ekonomike, pasi që ato përbëjnë një pjesë të madhe të aktivitetit në ekonominë kombëtare. Politika fiskale bashkë me politikën monetare janë dy komponentë themelore të politikës ekonomike shtetërore të cilat shfrytëzohen për qëllime makroekonomike: influencimin e produktit të përgjithshëm vendor, nivelin e punësimit, të ardhurën dhe nivelin e çmimeve. Politika fiskale lidhet me veprimet e qeverisë në ndryshimin e kompozicionit të të hyrave dhe shpenzimeve publike, me qëllim të menaxhimit të kërkesës agregate për të mbajtur rritje të qëndrueshme ekonomike me punësim relativisht të lartë, pa gjenerim të inflacionit, pa rritje të borxhit publik dhe me bilanc të kënaqshëm të pagesave.

Varësisht nga ecuritë ekonomike, politika fiskale mund të jetë ekspansioniste dhe e shtrënguar. Një ekspansion fiskal do të thotë shkurtim i taksave ose rritje e shpenzimeve

---

<sup>9</sup> ATK, 2003 Dokument elektronik i shkruar për politikën fiskale

publike me qëllim të stimulimit të rritjes së konsumit, respektivisht rritjen e kërkesës agregate. Kjo ndodh kur qeveria vëren ngecje apo shtim të ngadalshëm ekonomik ose kur numri i të papunëve është i lartë. Kështu, me rritjen e shpenzimeve publike dhe shkurtimin e taksave, individëve dhe firmave u lihet një sasi më e madhe parash për t'i shfrytëzuar në shpenzime konsumi ose investime. Kjo ndikon drejtpërdrejtë në rritjen e punësimit dhe shtimin ekonomik.

Ndërsa, politika fiskale shtrënguese do të thotë ulje e shpenzimeve publike dhe rritje e taksave. Kur qeveria synon uljen e kërkesës agregate për të ngadalësuar shtimin ekonomik apo uljen e inflacionit, përcaktohet për drejtimin e politikës fiskale shtrënguese. Nëpërmjet politikës fiskale shtrënguese ulet oferta e parasë e cila më tutje ul shpenzimet dhe kërkesën agregate. Njësoj, ulja e ofertës së parasë bën presion edhe në ngritjen e çmimeve të gjithmbarshme në ekonomi. Kur qeveria përcaktohet për politikën fiskale, ajo bën paraprakisht vlerësimin e një numri të madh faktorësh përfshirë dhe ecurinë e variablave dhe indikatorëve kryesore ekonomik dhe financiar, për shkak të ndikimit të tyre në shumën e të hyrave të grumbulluara përmes taksave me të cilat përmbushen nevojat e financimit të programeve qeveritare<sup>10</sup>.

Vendimet lidhur me politikat fiskale në masë të madhe varen nga konsideratat politike si, besueshmëria dhe roli që luan qeveria në ekonomi por edhe nga reagimet publike lidhur me drejtimin dhe veprimet e qeverisë. Vendimet e tilla mund të ndikohen edhe nga faktorët e jashtëm që do të thotë se qeveria mund të merr parasysh trendin global ekonomik dhe politikat fiskale të vendeve tjera, të cilat mund të kenë efekt në kompani vendore përmes beneficione fiskale.

---

<sup>10</sup> Brajshori, B. (2008). Taxation Ligjerate autorizuar

## 2.2. Objektivat e politikës fiskale

Në procesin e formulimit të politikës fiskale, politikbërësit përcaktojnë objektivat të cilat synojnë t'i realizojnë dhe instrumentet me të cilat ato objektiva bëhen të realizueshme, duke i'u përmbajtur detyrimisht principeve të menaxhimit fiskal, si:

- a) Transparenca lidhur me objektivat, implementimin e politikës fiskale dhe publikimin e llogarive publike;
- b) Stabiliteti i procesit të bërjes së politikës fiskale;
- c) Efikasiteti i ndikimit të politikës fiskale në ekonomi;
- d) Përgjegjësia në menaxhimin e financave publike;
- e) Efikasiteti i modelimit dhe implementimit të politikës fiskale;

Objektivat e politikës fiskale po ashtu lidhen me rritjen e mirëqenies së përgjithshme shoqërore si qëllim parësor i një shoqërie bashkëkohore. Kjo mirëqenie sigurohet vetëm në kushtet e një ambienti që e cilësojnë stabilitetin ekonomik, politik dhe social. Pra, kur flasim për objektivat e politikës fiskale kemi parasysh :

- 1) Përmbushjen e nevojave publike përmes një sistemi të shëndoshë të financimit publik;
- 2) Realizimin e punësimit të plotë;
- 3) Rritjen e normës së shtimit ekonomik;
- 4) Ruajtjen e stabilitetit të çmimeve;
- 5) Stabilitetin e bilancit të pagesave;
- 6) Përmirësimin e kushteve të punës duke përfshirë përmirësimin e strukturës kualifikuese të fuqisë punëtore dhe përparimin teknologjik;
- 7) Stimulimin e kursimeve;
- 8) Stimulimin e investimeve;
- 9) Rritjen e aftësisë konkurruese të produkteve dhe shërbimeve vendore;
- 10) Rritjen e cilësisë së shërbimeve në arsim dhe shëndetësi.

Realizimi i këtyre objektivave varet nga: aftësia e qeverisë për bashkërenditjen e tyre me instrumentet fiskale për të influencuar kompozicionin dhe nivelin e kërkesës agregate; saktësia e analizave makroekonomike lidhur me trendët e indikatorëve kryesorë ekonomik dhe financiar; rregullimi dhe marrëveshjet institucionale për koordinimin e politikave makroekonomike <sup>11</sup> .

### **2. 3. Roli i politikës fiskale në politikën ekonomike**

Polititika fiskale paraqet komponentën më të rëndësishme të politikës ekonomike. Janë dy arsye për këtë :

1. Politika ekonomike i përcakton kriteret dhe qëllimet e politikës fiskale, dhe
2. Për shkak të lidhmërisë së qëllimeve dhe instrumenteve të politikës ekonomike nëpërmjet të cilave realizohen qëllimet e saj pjese e së cilës është edhe politika fiskale<sup>12</sup> .

Politika ekonomike e përcakton procesin në të cilin formohen qëllimet shoqërore, bëhet zgjedhja e instrumenteve, nxirren vendimet e qeverisë dhe mirren masat e nevojshme për implementimin e tyre. Bartës të politikës ekonomike janë të gjitha organet të cilat ndikojnë në përcaktimin dhe në realizimin e qëllimeve të politikës ekonomike (organet shtetërore, bankat, bashkësitë e sigurimeve, partitë politike, grupet e interesit, organizatat ndërkombëtare etj). Veçoritë themelore të bartësve të politikës ekonomike janë: definimi i interesit, aftësia vendimmarrëse, aftësia e veprimit, pavarësia e veprimit.

Qëllimet e politikës ekonomike janë të shumta por më kryesoret janë, rritja e punësimit, stabilizimi i çmimeve, përmirësimi i bilancit të pagesave (afatshkurtëra), pastaj rritja

---

<sup>11</sup> ATK & MFE (2003) Dokument elektronik, Politika fiskale

<sup>12</sup> Brajshori, B. 2008. Taxation, Sllajdet për lëndën politika fiskale-politiken ekonomike

ekonomike, alokimi i faktorëve të prodhimit, përmbushja e nevojave kolektive, përmirësimi i shpërndarjes së të ardhurave dhe pasurisë, stimulimi ekonomik i degëve dhe regjioneve (qëllime afatgjata) dhe qëllimet afatmesme; - përmirësimi i modelit të konsumit individual, sigurimi i ofertës me produkte bazike, madhësia dhe përmirësimi i strukturës së popullsisë etj.

Sa më i madh që të jetë numri i qëllimeve, aq më i vështirë ato implementohen, por edhe për faktin se ato ndikojnë në njëri-tjetrin. Realizimi i qëllimeve bëhet i mundur me aplikimin e instrumenteve të caktuara të politikës ekonomike.

Instrumentet mund të ndahen në:

- instrumentet e financave publike ( politika fiskale)
- instrumentet e politikës kredito-monetare
- instrumentet e politikës së çmimeve
- instrumentet e bilancit të jashtëm tregtar dhe devizor
- instrumentet e shpërndarjes së të ardhurave
- instrumentet e kontrollit të drejtpërdrejtë dhe të rregullativës ligjore<sup>13</sup>.

Rëndësinë më të madhe për realizimin e qëllimeve të politikës ekonomike e kanë instrumentet e financave publike (instrumentet e të hyrave dhe instrumentet e të dalave ). Në kategorinë e parë bëjnë pjesë, tatimet, doganat dhe transferet e ndryshme, kurse në kategorinë e dytë të instrumenteve hyjnë investimet shtetërore, subvencionet dhe transferet e kapitalit të ndërmarrjeve, transferet për pensionet, rezervat shtetërore, shpenzimet rrjedhëse për mallra dhe shërbime, shpenzimet për paga dhe transferet në botën e jashtme. Sa më të detalizuar dhe më të aplikueshëm të jenë instrumentet e politikës fiskale, qëllimet

---

<sup>13</sup> Komoni S, (2008). Financat Publike. Fq, 17

e politikës ekonomike realizohen më lehtë. Prej këtu edhe rrjedh rol edhe rëndësia e politikës fiskale në realizimin e qëllimeve të politikës ekonomike.

Sipas Musgarevit politika fiskale ndahet në tre fusha të qëllimeve: (alokimi, shpërndarja dhe stabilizimi).

- Nëpërmjet alokimit ndikohet në investime dhe në përdorimin e resurseve në mënyrë që të arrihen rezultate.
- Shpërndarja përbëhet nga ndryshimet e shpërndarjes në treg, pra nga shpërndarja e të ardhurave dhe e pasurisë.
- Stabilizimi është i obliguar të luaj rolin e faktorit stabilizues në ekonominë e tregut dhe të vendosë baraspeshë në mes çmimeve, faktorëve ekonomik dhe bilancit të pagesave.

Tri qëllimet e përmendura më lartë nuk janë tipike vetëm për politikën fiskale por edhe për atë ekonomike. Andaj, politika fiskale dallon nga fushat tjera të politikës ekonomike sipas instrumenteve të saj e jo sipas qëllimeve. Si qëllim më i rëndësishëm i politikës fiskale është zhvillimi ekonomik dhe nxitja e investimeve, por edhe mbrojtja e ekonomisë vendore. Instrumenti më i rëndësishëm i politikës fiskale – **tatimi**<sup>14</sup>.

---

<sup>14</sup> Brajshori, B. (2008). Taxation Slaid 4



## 2.4. Efektet e politikës fiskale

Edhe më herët i kemi theksuar katër faktor që politikën ekonomike e bëjnë më efektive: realizimi i qëllimeve, harmonizimi qëllimeve dhe instrumenteve, koordinimi dhe përzgjedhja e instrumenteve më të mira dhe marrja me kohë e masave. Efekti më i mirë stabilizues i politikës fiskale arrihet me kombinimin e instrumenteve dhe të masave të politikës fiskale por edhe të politikës fiskale dhe asaj monetare.

Thënë thjeshtë, politika fiskale shfrytëzon sistemin tatimor dhe shpenzimet qeveritare për të ndikuar në ekonomi dhe për të arritur një sërë objektivash të tjera. Ndërsa nga ana tjetër politika monetare, shfrytëzon instrumente si ndryshimet në ofertën e parasë dhe me shkallën e interesit me qëllim që të ndikojë në nivelin e çmimeve dhe koston e kredisë. Zakonisht politika monetare përcaktohet nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK)<sup>15</sup>.

- Politika fiskale më fuqishëm ndikon në rregullimin e nivelit të konsumit se sa të investimeve, kurse te nxitja e rritjes ekonomike, përparësi i jepet politikës monetare.
- Politika fiskale më e fuqishme është në rregullimin e kërkesës agregate, çmimeve dhe punësimit, kurse politika monetare në mbajtjen e baraspeshës në bilancin e pagesave.
- Politika fiskale për shkak të ndikimit direkt në kërkesë, është më e efektshme në luftimin e depresionit, kurse politika monetare në luftimin e inflacionit.
- Dominon mendimi se politika fiskale është më e fuqishme se ajo monetare për aq sa elasticiteti i kamatës për kërkesë të fondeve monetare të jetë më i madh dhe e kundërta<sup>16</sup>.

---

<sup>15</sup> BQK <http://www.bqk-kos.org/index.html>

<sup>16</sup> Brajshori, B. (2008). Taxation Slaid 3 Roli stabilizues i politikës fiskale

## **2.5. Problemet metodologjike të matjes së efekteve stabilizuese të politikës fiskale**

Sot roli i politikës fiskale nuk është më kontestues por bindshëm ndikon në ecuritë tjera ekonomike. Kjo për faktin se mbledhja e të hyrave dhe realizimi i të dalave publike, prodhon efekte në relacionin e agregatëve ekonomik dhe në subjektet ekonomike.

- Politika fiskale vepron në nivelin dhe strukturën e kërkesës agregate kurse të dalat publike veprojnë në mënyrë ekspansive në kërkesën agregate në dallim prej të hyrave të cilat veprojnë në mënyrë kontraktuale.
- Saldo e të dalave dhe të hyrave të përgjithshme publike e financuar nga hyrja e shtetit në borxhe në tregun financiar ose edhe prej misionit primar, ndikon në nivelin e likuiditetit në ekonomi, gjendje kjo e cila ndikon në ecuritë ekonomike nëpërmjet “faktorit të likuiditetit”.
- Politika selektive e të dalave dhe të hyrave publike i ndryshon çmimet relative të supstiteve dhe me ndihmën e “faktorit supstituiv” ndikon në përcaktimin e subjekteve ekonomike në mes të kursimit dhe konsumit, eksportit dhe shitjeve në vend apo importit dhe blerjeve në vend të teknologjisë, punës dhe kapitalit <sup>17</sup>.

---

<sup>17</sup> Brajshori, B. (2008). Taxation Slaid 3 Roli stabilizues i politikës fiskale

## 2.6. Politika fiskale në Kosovë

Kosova si një vend i vogël në ballkanë, mund të orientohet në ndërtimin e sistemit të ekonomisë sipas kërkesave të një ekonomie të hapur ndaj tregut evropian dhe atij botëror, me një politikë rregullative dhe me liberalizim ekonomik. Ky mund të jetë sistem ekonomik që krijon një ambient të përshtatshëm për integrimin e ekonomisë së Kosovës në rajon e më gjerë, stimulimin e bashkëpunimit ekonomik dhe që nxitë investimet e përbashkëta me partnerët e jashtëm<sup>18</sup>.

Politika fiskale si elementi kyq i politikës ekonomike harton analiza për nevoja të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave dhe të vetë qeverisë për të mundësuar një rishpërndarje më optimale buxhetore por dhe për të siguruar të hyra të nevojshme buxhetore me një shpërndarje minimal të aktivitetit ekonomik. Zhvillimi i politikës fiskale në Kosovë në periudhën e pasluftës (1999) bazohet kryesisht në të hyrat dhe shpenzimet (të dalat) qeveritare për arritjen e qëllimeve të caktuara ekonomike dhe sociale dhe njëherit për të pasur influencë në treguesit makroekonomik<sup>19</sup>.

Misioni i UNMIK-ut në Kosovë pasluftës është përcaktuar në sigurimin e donacioneve me qëllim të plotësimit të nevojave emergjente, për të financuar dhe për të vënë në aktivizim të administratës publike, rregullimin/rehabilitimin e infrastruktures dhe të shërbimeve publike. Në shtator të vitit 1999 në Kosovë themelohet Autoriteti Qendror Fiskal (AQF) nga Administrata Civile e Kombeve të bashkuara, me qëllim për të ndërtuar politikën fiskale në vend. Në kushtet specifike të Kosovës, politika fiskale ishte e shtrënguar që të mobilizojë mjete financiare për mbulimin e nevojave publike. Pra, fillimisht ishte e përcaktuar që të mbledh mjetet financiare për arkën buxhetore duke anashkaluar aspektin zhvillimor të Kosovës.

---

<sup>18</sup> ATK & MFE (2003) Dokument elektronik, Politika fiskale

<sup>19</sup> Komoni S, (2008). Financat Publike Fq. 129

Me politikën fiskale shfrytësohen të hyrat ( të ardhurat) dhe shpenzimet (të dalat) publike për realizimin e politikës ekonomike. Pra mund të themi se politika fiskale merret kryesisht me analiza dhe përpilim politikash. Kjo vlen si për politikat tatimore dhe doganore, përfshirë tatimet direkte dhe indirekte ( si tatimin në të ardhurat e korporatave, tatimin në të ardhura personale, tatimin mbi vlerën e shtuar, tarifatat doganore, akcizat, etj.). Hulimtimin e përvojave dhe politikave më të mira të Bashkimit Evropian, në mënyrë që Kosova të jetë sa më afër politikave dhe legjislacionit fiskal të këtyre vendeve <sup>20</sup>.

Në fillim instrumentet financiare në Kosovë ishin të përqendruar në sigurimin e të hyrave publike (buxhetore) përmes tatimit të paragjykuar, tatimit në shitje, tatimit në shërbime, doganat dhe akcizat, ku në fillim ngarkesa tatimore më e madhe ishte e aplikuar te bizneset të cilat e mbulonin mbi 95% të të hyrave buxhetore me anë të tatimeve dhe doganave, që bizneset nuk ishin të kënaqura.

Më vonë me aplikimin e llojeve tjera tatimore në vend, siç janë: tatimi mbi vlerën e shtuar (TVSH), tatimi në pron, tatimi në fitim, tatimi në paga, që reflektoi në zvoglimin e ngarkesës tatimore nëpër bizneset dhe një pjesë e tatimit është bartur tek qytetarët. Mungesa e planit të mirfilltë strategjik në Kosovë dhe mungesa e të dhënave statistikore mbi treguesit makroekonomik ishin shkaqet e vështirimit të ndërtimit të politikës fiskale të qëndrueshme. Mirëpo, në një anë politika fiskale në Kosovë ka dhënë efekte pozitive sa i përket krijimit të të hyrave vetanake buxhetore ndërsa nga ana tjetër nuk ka treguar efekt në zhvillimin e rrijtes ekonomike.

**Baza fiskale** - Zgjerimi i bazës fiskale dhe harmonizimi i ngarkesës fiskale me mundësitë e taksapaguesve

- Ngarkesat fiskale të jenë të përballueshme për taksapaguesit.

---

<sup>20</sup> <http://mef-rks.org/>

- Të ndihen efektet e taksave dhe tatimeve në funksionimin e shërbimeve publike në dobi të taksapaguesve.
- Lehtësitë tatimore në funksion zhvillimor
- Barazi fiskale dhe krijimi i opinionit pozitiv tek taksapaguesit
- Rishqyrtimi i lartësisë së taksave me mundësi të zvogëlimit të tyre.
- Harmonizimi i ngarkesave fiskale me të ardhurat, pasurinë dhe aftësinë paguese të taksapaguesve.
- Pasqyrimi i masave për zhvillimin e lëmive publike, infrastrukturës, forcimit të rendit dhe ligjshmërisë.
- Zgjerimi i bazës fiskale mbi të gjitha burimet e fitimit të individëve dhe kompanive.
- Aplikimi i lehtësirave për importin e makinerisë së shkatërruar , importin e lëndës së parë për prodhimtarinë për eksport dhe investime.
- Zbatimi rigoroz i ligjshmërisë dhe disiplinës në organet doganore dhe tatimore; mbulimi i të gjitha pikave kufitare të Kosovës si pika doganore.
- UNMIK, Pushteti lokal AQF, Oda ekonomike, Parlamenti dhe Qeveria
- Qeveria dhe Ministria e Financave<sup>21</sup>

---

<sup>21</sup> ATK & MFE (2003) Dokument elektronik, Politika fiskale

## *Kapitulli 2*

### **3. SISTEMI TATIMOR DHE NDËRTIMI I TIJ**

#### **3.1. Domethënia e tatimve**

“Që nga momenti që dikush lind si shtetas, ai i nënshtrohet tatimeve”. Të gjitha mjetet e mundshme financiare ndikohen nga ligjet tatimore, pasi këto ligje në thelb ndikojnë në të gjitha shkëmbimet e parave ose të mallrave të shtetasve dhe meqenë se ligjet e tatimeve zakonisht dallojnë mes fakteve të ndryshëm, gjithashtu barra e tatimeve ndryshon. Njëashtu është e ditur se që çdo qenie njerëzore mundohet të paguaj sa më pak që të jetë e mundur tatime, ndërsa nga ana tjetër qeveria në mënyrë të drejtpërdrejt dhe të tërthorët tenton të nxit ekonomin përmes grumbullimit të të hyrave të saj nga sistemi tatimor. Gjithashtu synimi i qeverisë është të hartoj ligje tatimore të cilat orjentojnë shpërndarjen e drejt të barrës tatimore <sup>22</sup>.

Askujt nuk i pëlqen të paguajë tatime por shtetit i duhen fonde të nevojshme për të funksionuar dhe për t`i kryer veprimet e tij. Në kuptimin më të plotë të fjalës tatimet janë burim kryesor i mbledhjes së të hyrave publike me të cilat shteti mundohet t`i plotësojë shpenzimet publike që ndodhen në kapacitetin e tij, pa marr parasysh zhvillin e tij si shtet. Tatimi gjithashtu është një tipar kryesor i një sistemi ligjor që kërkon të arrijë konkurrencën e lire dhe liri për të mbajtur prona. Në një sistemin juridik e gjithë porona i takon shtetit, nuk ka nevojë për tatime, shtetit i nevojitet të krijojë struktura që sigurojnë pagesën e tatimeve. Këto pagesa duhet të jenë efikase që t`i lejojnë qeverisë të planifikojë që në fillim mjetet monetare të mundshme. Nëse lind nevoja tatimet duhet të krijohen dhe kundër vullnetit të individëve <sup>23</sup>. Studimi i tatimit është shumë i lidhur ngusht me rolin dhe funksionin e shtetit. Tatimi është njëra nga format përmes të cilës shteti i fiton të hyrat

---

<sup>22</sup> Agjensia Europiane për rindërtim 2006 Projekt për mbështetje ligjore, fq.2

<sup>23</sup> Komoni S, (2008). Financat Publike Fq. 43

e tij buxhetore. Prandaj nga kjo del se qëllimi i tatimit (i të tatuarit) është mbledhja e mjeteve financiare për shtetin dhe organet e tjera publike të cilat janë të nevojshme për financimin e funksioneve të tyre, pra ky është qëllim fiskal i tatimit<sup>24</sup>. Duket qartë se çdo qeveri ka shpenzime dhe për mbulimin e këtyre shpenzimeve nevojiten para, me të cilat qeveria paguanë pagat e punonjësve të saj dhe paguan për shërbime që i ofron për shtetasit e saj. Qeveria merr të ardhura nga burime të ndryshme të të hyrave, por më e rëndësishme që vlen të theksohet, është mbedhja e parave nëpërmjet tatimeve. Tatimet janë të mbledhura nga përqindja e çdo qytetari dhe shitja e taksave nga të gjithë. Këto janë të vendosur së bashku për të ndihmuar por jo për të lënduar qytetarin. Tatimi drejtohet mbi parimin “merr pak para nga të gjithë për të mirën e mundshme për të të gjithë”<sup>25</sup>.

Rëndësia e tatimeve në historinë e saj ka vazhduar dhe është rritur me intenzitet të lartë në zgjerimin e përhershëm të detyruesve tatimor, të numrit të llojeve të tatimeve dhe të rritjes së ngarkesës tatimore. Tatimet në fillim të shfaqjes së tyre ishin të hyra detyruese të jashtëzakonshme të shtetit, të cilat ishin të hyra të mbledhura nga një grup i ngushtë i personave me anë të cilat janë të plotësuar nevojat e veçanta dhe me destinim të caktuar për plotësimin e tyre të shtetit. Ndërsa tani mund të theksojmë se janë pjesa më e rëndësishme dhe më e përhershme e të të hyrave shtetërore, që janë të hyra të rregulta dhe që mbledhen nga personat fizik (qytetarëve) dhe atyre juridik. Sot mund të gjinden shtete ne botë që nivelin e mbledhjes së tatimit e kanë deri në 40% të të ardhurave nacionale <sup>26</sup>. Mirëpo nëse ju referohemi literatures do të vrejme teori të ndryshme në lidhje me esencën se çfarë janë tatimet. Një definicion i cili përdorej në vendet kapitaliste për tatimin nuk mund të përdorej në vendet të cilat tanimë janë në zhvillim. Prandaj ekzistojnë definicione të shumta për tatimin dhe disa prej të cilave do t'i paraqesim në vijim:

- Me tatime nënkuptojmë dhënjen e të mirave reale (para dhe të mira tjera natyrale) shtetit dhe organeve tjera juridike-shtetërore me qëllim të plotësimin të nevojave

---

<sup>24</sup> Agjensia Europiane për rindërtim 2006 Projekt për mbështetje ligjore, fq.3

<sup>26</sup> Komoni S, (2008). Financat Publike Fq. 43

publike nga ana e organeve të pushtetit, të cilat mblidhen në bazë të mënyrës së përcaktuar dhe në shuma të caktuara sipas një mase të përgjithshme matëse (Eheberg)

- Tatimi është kontribut me forcë i njësisve ekonomike, pjesërisht për mbulimin e nevojave të përbashkëta shtetërore dhe publike dhe pjesërisht për shpërndarje tjetër e të të ardhurës kombëtare nga teoriticienti (Wagner)
- Tatimet mund të konsiderohen ato të dhëna të cilat i mbledh shteti dhe organet e ngushta publike, nëse nuk shërbejnë si kompensim për kundëshërbime të veçanta për shtetin dhe organet e tij” (Neuman)
- Tatimet janë ajo sasi e të ardhurave të qytetarëve të cilat i mbledh shteti me qëllim të blerjes së mjeteve për plotësimin e shpenzimeve në lidhje me ushtrimin e funksioneve publike (Viti De Marco).
- Tatimi është e dhënë e obliguar të cilën individët i dhënë shtetit me qëllim të plotësimit të shpenzimeve me interes publik, pavarësisht nga vështirësitë (Seligan).

Studimi vë në pah se qëllimi i këtyre teorive është që të kuptohet më të mirë koncepti i tatimeve dhe vërejmë se tatimet në një mënyrë mblidhen me forcë nga shteti për plotësimin e nevojave financiare publike apo përmbushjen e nevojave qeveritare të një vendi. Pra duke u bazuar në literatur mund të konkludojmë se tatimet në botën bashkohore janë të hyra të pakthyeshme, derivative dhe mblidhen me forcë për interesa publike dhe për të cilat shteti nuk jep kompensim të drejtëpërdrejt që praktikohet sot edhe në Kosovë. Sot shteti është fakt shoqëror dhe tatimi është “kontribut” i qytetarit për shtetin i cili paguhet duke u bazuar në mekanizmat demokratik parlamentar. Tatimet kanë rol udhëheqës në krahasim me instrumentet tjera fiskale për mbledhjen e të hyrave, po ashtu tatimet emërtohen si instrument fiskal me anë të të cilit shteti realizon vëllimin më të madh të të hyrave publike<sup>27</sup>.

---

<sup>27</sup> Brajshori, B. (2008). Taxation Slaidet 5



### 3.2 Sistemi tatimor

Sistemi tatimor paraqet të gjitha format e tatimit të cilat aplikohen në një vend, e që janë të lidhura në një tërësi me ndihmën e të cilave mund të realizohen qëllimet e politikës financiare dhe ekonomike. Nëse bëjmë një krahasim me vendet tjera do të shohim se nuk eksiztojnë dy shtete në të cilat tatimi bëhet në forma të njejtë të tatimit apo që këto lloje të tatimit të kenë rol dhe vend të njëjtë në ato sisteme, për arsye se sistemi tatimor është rezultat i veprimit të rregullimit politik, të të ardhurave për një banor, situatave në bilancin e pagesave, etj. Sot nuk ekziston asnjë shtet në të cilin të tatuarit bëhet vetëm me një lloj të vetëm të tatimit, pasi që në sistemin tatimor bashkohor bëhet me aplikimin e një numri të madh të llojeve të tatimit. Megjithatë në teori dhe praktikë janë të njohura dy forma të sistemit tatimor monizmi dhe pluralizmi tatimor .

Monizmi tatimor është lloj i sistemit tatimor të cilin e kanë përfaqësuar fiziokratët për herë të parë në Francë në shek. XVI, i cili kishte esencën se ky lloj i tatimit kishte burimin në bujqësi (tokë) në të cilin krijohet mbi vlera (produkti i pastër). Dhe si përparsi e Monizmi pasi që me aplikimin e vetëm të një lloj të vetëm të tatimit ishte më i lehtë dhe më i thjeshtë, më shpejt mblidhej, më lehtë kontrolloj etj. Mirëpo sot nuk e hasim në asnjë vend i cili paset vetëm me një lloj të tatimit, pasi që në këtë mënyrë nuk do të përfshihej e tërë fuqija ekonomike e obliguesit tatimor i cili krijon të hyra nga burimet e ndryshme, pasi që një lloj i tatimit do të krijonte edhe norma të larta tatimore për mbulimin e shpenzimeve shtetërore.

Sot gjejmë shtetet bashkohore të cilat kanë të aplikuar sistemin tatimor të pluralizmit i cili ky sistem bazohet në shumë lloje (forma) të tatimit ku me ndihmën e të cilit realizohen politika dhe qëllimet e caktuara ekonomike financiare, i cili ky lloj përfaqësohet me aplikimin e llojeve të shumta tatimore. Vazhdimisht theksuam se nuk përdoren në dy shtete sistem i njejtë tatimor, mirëpo në realitet sistemet tatimore të një shteti pak a shumë kanë dhe ngjajshmeri në mes veti shteti me shtetin (p.sh shtetet fqinje). Kjo ngjajshmeri e

sistemeve tatimore vrehet me themelimin e bashkësive ekonomike të cilat nxisin dhe mundësojnë ecurinë integruese në prodhim, qarkullim dhe financa.

Në sistemet e sotme tatimore po aplikohen një numër gjithnjë e më i madh i formave tatimore, bëhet fjalë për tatimin që i ngarojnë të ardhurat, të hyrat, pronën, rritjen e vlerës së pronës ose bartjen e saj, por dhe tatimet që e ngarkojnë konsumin e të ardhurave. Siç e cekëm dhe më parë sistemi tatimor i shteteve moderne përfshin një numër shumë të madh të llojeve të tatimit. Por të gjitha këto lloje të tatimit nuk e kanë rëndësinë e njejtë në sistemin tatimor nga pikëpamja ekonomike-financiare, sociale etj. Pasi që disa lloje të tatimeve kanë pjesëmarrje më të madhe, kurse disa lloje të tatimeve kanë pjesëmarrje më të vogël në të hyrat e mbledhura kryesisht nga tatimet. Llojet më të rëndësishme të tatimit në sistemin tatimor të shteteve bashkohore janë mbledhja e tatimit në të ardhura personave juridik dhe fizik si dhe tatimi i përgjithshëm në qarkullim, ku nëse themi se 70-85% e të hyrave tatimore rrjedhin nga dy llojet e cekura më lartë janë ndërsa pjesa tjetër mbledhet nga të gjitha llojet tjera të tatimit, ku mund të cekim se këto tatime përbëjnë pjesën themelore të sistemit tatimor dhe ndryshe quhen edhe tatime themelore. Bazueshmëria e tatimit qëndron në nevojën e sigurimit të burimeve të mjeteve për ushtrimin e funksioneve vitale të shtetit. Për të siguruar mjete, shtetet së pari i përcaktojnë veprimtaritë ekonomike, ku do të kryhet tatimi. Në fillimin e tatimit burimi më i madh i të hyrave kanë qenë taksat doganore dhe kompensimi i shfrytëzimit të rrugëve, që janë dy veprimari në të cilat transaksionet mund të mbikëqyren lehtë<sup>28</sup>.

Tatimet kanë një domethënie të madhe nga pikëpamja e mundësisë së grumbullimit të të hyrave për shtetin. Pjesëmarrja e tyre në të hyrat e përgjithshme që i grumbullon shteti nga burimet e vendit është shumë e madhe. Së fundmi, rezulton se rëndësia e përcaktimit të sistemit të tatimeve që do të jetë efektiv dhe që nuk do të shkaktojë rënien e prodhimit dhe të konsumit dhe që do ta promovojë parimin e drejtësisë në tatim. Në praktikë kjo arrihet duke zgjeruar bazën tatimore, duke zgjeruar shkallët e ulëta tatimore dhe me numër sa më të vogël të lirimeve tatimore. Pra, një sistem tatimor mund të përkufizohet edhe si një barrë

---

<sup>28</sup> Komoni S, (2008). Financat Publike Fq. 121, 122

(e vendosur mbi individët ose mbi pronën), pra një sistem tatimore "nuk është një pagesë apo dhurat vullnetare" por një kontribut në fuqi<sup>29</sup>.

### **3.3. Disavantazhet e sistemit tatiomor të komplikuar**

Shtetasi nuk do të arrijë të kuptojë dhe t'i njohë në detaje të drejtat e tij nëse sistemi tatimor vazhdon dhe bëhet më i komplikuar, gjë që atyre iu duhet të angazhojnë ekspert për këto lloj lëmie të paguajnë me shuma të mëdha parash për ekspertizën e tyre. E gjithë kjo mund të spjegohet më konkret, ku të duket se vetëm të varfërit dhe ata më pak të mënçurit duhet t'i paguajnë këto tatime kur dihet se sjanë në gjendje t'i përballojnë këtë lloj të kosotos, ndërsa të pasurit marrin apo mund të angazhojnë specialist të mirfilltë që të paguajnë sa më pak tatime. Dhe e gjithë kjo ka një refletk të të padrejtë në idenë e moralit të tatimpagusit<sup>30</sup>.

### **3.4. Struktura e sitemit tatimor në Bashkimin European BE**

Trendet aktuale të BE-së, lidhur me strukturat e tatimeve (tatimet direkte, indirekte dhe tatimeve kontributet sociale) në nivelin e të ardhurave personale normat e timeve të cilat ndryshojnë në mënyrë shumë të konsiderueshme, që varion nga 16% në 59% , ndërsa niveli i normave të tatimit në korporata vazhdojnë rënie të shpejtë në të gjithë BE-në. Nëse marrim BE-në, si një tërsi që është një zonë me taksa të larta, të dhënat në vitin 2006, të cilat janë të dhëna të hollësishme në dispozicion, e përgjithshme të mbledhjes së tatimeve, arriti në 39,9% të GDP-së. Kjo vlerë është rreth 12 % më e lartë se sa që kishte të regjistruar në Shtetet e Bashkuara dhe Japonia të 2006. Mesatarja e përgjithëshme e lartë nënkupton se në asnjë mënyrë nuk është se të gjitha vendet anëtare të BE-së tregojnë një raport të lartë të tatimeve, përkundrazi, ka dhe shumë shteteve anëtare të saj shfaqin raporte nën 35% të normave tatimore<sup>31</sup>.

---

<sup>29</sup> Wikipedia, 2009 <http://en.wikipedia.org/wiki/Tax>

<sup>29</sup> [http://www.associatedcontent.com/article/58978/what\\_are\\_taxes\\_and\\_why\\_do\\_they\\_exist.htm](http://www.associatedcontent.com/article/58978/what_are_taxes_and_why_do_they_exist.htm)

<sup>30</sup> Agjensia Europiane për rindërtim 2006 Projekt për mbështetje ligjore, fq.4

<sup>31</sup> <http://conferinta.uav.ro/files/conferinta-2008/47.pdf>

## *Kapitulli 3*

### **4. ZHVILLIMI I SISTEMIT TATIMOR FUNKSIONOR NË KOSOVË NË PERIUDHEN E PASLUFTËS**

#### **4.1. Sistemi tatimore në Kosovë**

Politika tatimore në Kosovë është e orientuar drejt rregulloreve të thjeshta të cilat sigurojnë bazë të gjerë tatimore dhe parandalojnë evazionin tatimor. Tatimet dallojnë në bazë të formës së biznesit dhe qarkullimit vjetor. Politika fiskale është pjesë e politikës së përgjithshme ekonomike, që në Kosovë synon krijimin e një ekonomie funksionuese që bazohet në treg, në nivelet e tatimit në Kosovë, si edhe më gjerë, që janë rezultat i një detyre të ndërlikuar balancuese ndërmjet nevojave të buxhetit dhe efekteve të tatimeve në zhvillimin ekonomik. Ndërsa tatimet janë barrë e kompanive dhe ekonomisë, të ardhurat që ato i krijojnë i financojnë shërbimet publike që janë të nevojshme për aktivitetin ekonomik. P.sh. qeveria mirëmban rrugët që kompanitë i shfrytëzojnë për ta sjellë lëndën e parë dhe për t'i transportuar produktet e tyre përfundimtare dhe shkollat publike ofrojnë arsim që u siguron ndërmarrjeve nëpunës të kualifikuar për të cilët ato kanë nevojë.

Shumica e investimit kapital në shërbimet publike në Kosovë ende financohet nga donatorët, kontributet e të cilëve janë duke u zvogëluar gradualisht pasi Kosova po merr përsipër gjithnjë e më tepër këtë përgjegjësi<sup>32</sup>. Prandaj, humbja e të ardhurave e shkaktuar nga zbritja e një lloji të tatimit, do të duhej të kompensohej duke ngritur, p.sh. nivelin e tatimit tjetër. Po t'i kushtohej kujdes kërkesës së bashkësisë së biznesit për taksa më të

---

<sup>32</sup> Komoni S, (2008). Financat Publike Fq. 129

ulëta doganore (të njohura si tatimi në import), humbja rezultuese e të ardhurave do të duhej të kompensohej në ndonjë mënyrë tjetër<sup>33</sup>.

Bizneset do të dëshironin ta shihnin heqjen e taksave doganore për mallërat kapitale dhe për lëndën e parë, e jo për produktet e destinuar për konsumim. Institucionet financiare ndërkombëtare nuk e favorizojnë zbatimin e një sistemi të tillë të dyfishtë. Një arsye është se ajo do t'i inkurajonte prodhuesit vendorë për të prodhuar vetëm për tregun e brendshëm të mbrojtur dhe do t'i parandalonte që të ishin të detyruar të ballafaqoheshin me konkurrencën rajonale dhe ndërkombëtare. Sistemi i dyfishtë gjithashtu do ta shtonte rrezikun e klasifikimit të gabuar të mallërave dhe të korrupsionit. Administrimi i tij do të kërkonte kapacitet të shtrenjtë plotësues në Administratën Tatimore të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave.

Në përgjithësi, Kosova ka nivele të ulëta të tatimeve. TVSH-ja në Kosovë është më e ulëta në rajon, më e ulët se shkalla standarde minimale që zbatohet në Bashkësinë Evropiane. Importet nga Maqedonia dhe eksportet për në Maqedoni nuk ngarkohen me taksa doganore (përveç 1% taksa administrative), njësoj si ato që vijnë nga Serbia dhe Mali i Zi dhe që shkojnë në Serbi dhe Mal të Zi.

Pasi TVSH-ja dhe tatimet e tjera të bëhen burime më të rëndësishme të të ardhurave, taksa doganore prej 10% do ta humbasë rëndësinë e vet si krijuese e të ardhurave. Por shumë ekspertë duket se pajtohen se edhe tani ekzistojnë faktorë më të rëndësishëm që mund ta stimulojnë prodhimtarinë vendore dhe eksportet, si sistemi i zbritjes së taksave doganore për mallra kapitale dhe inpute të mesme që përdoren për prodhimin e mallërave për eksport<sup>34</sup>.

---

<sup>33</sup> ATK & MFE (2003) Dokument elektronik, Politika fiskale

<sup>34</sup> Po, aty

## 4.2. Ndërtimi i sistemit tatimor në Kosovë

Ndërtimi i sistemit tatimor në Kosovë ka filluar nga periudha e pasluftës, me ritëm të ngadalshëm, duke vazhduar me reformime të ndryshme me qëllim të krijimit të një politike fiskale sa më stabile dhe funksionale për të ngritur nivelin më të lartë të mbushjes së arkën shtetërore. Në Kosovë sistemi tatimor i ri filloi të ndërtohet në vitin 1999 dhe i cili ishte i bazuar vetëm në tatimin e bizneseve. Dhe si për fillim në Kosovë funksiononin vetëm këto lloje të tatimeve siç janë:

1. Tatimi i Paragjykuar
2. Tatimi në shitje
3. Tatimi në shërbime dhe
4. Taksat doganore

Këto lloje të pakta të tatimeve kanë shërbyer për sigurimin e mjeteve monetare për të hyrat në buxhet. Ndërsa në vitin 2001 dhe 2002 sistemi tatimor i Kosovës zgjerohet me lloje të reja të tatimit duke përfshirë këto lloje të tatimit:

1. TVSh (tatimi mbi vlerën e shtuar) me normë prej 15%
2. Tatimi në të ardhura presonale (tatimi në paga)
3. Tatimi në fitim si dhe
4. Tatimi në pronë

Me këtë lloj të tatimit baza tatimore është zgjeruar dhe ngarkesa tatimore e bizneseve është zvogëluar dhe si përparsi e shtimit të llojeve të shumta tatimore janë rritur dhe të hyrat buxhetore duke parë se të hyrat nga njëri lloj mblidhen me shpejt më sigurt etj. Mirëpo në vitin 2005 sistemi tatimor i Kosovës aplikonte reforma të reja, ku tatimin e

paragjykuar dhe tatimin në paga e shëndrrohen në tatimin në të ardhura personale, si dhe është zvëndësuar tatimi në fitim me tatimin në të ardhura të kooroprative<sup>35</sup>.

Ndërsa tani më sistemi tatimor i Kosoves ka këtë përbërje të llojeve të tatimeve:

1. Tatimi në të ardhura personale,
2. TVSH (tatimi mbi vleren e shtuar),
3. Tatimi në të ardhura të korporatave dhe
4. Tatimi në pronë<sup>36</sup>.

Politika fiskale është element qenësor që krijon në njerën anë mirëqenjen e shtetit nëpërmjet të tatimeve, taksave dhe të hyrave të tjera të cilat reflektohen në buxhetin e vendit dhe në anën tjetër zhvillim ekonomik më të balancuar. Nëse nuk krijojmë politikë fiskale konstante me ndikim në zhvillimin ekonomik dhe veprimtarit tjera, atëherë lindin edhe defekte të cilat ndikojnë në drejtim të kundërt.

Kosova menjëherë pasluftës nuk kishte sistem të tatimeve dhe taksave në mungesë të legjislacionit përkatës. Andaj administrata ndërkombëtare tre muaj pasluftës hartoi disa rregullore të cilat mundësuan mbledhjen e taksave doganore në pikat kufitare me Maqedoninë dhe Shqipërinë si dhe inkasimin e tatimit brenda me implementimin e tatimit të paragjykuar, tatimit për hotele dhe restorante si dhe tatimit në premitë e sigurimeve. Këto tatime dhe taksa ishin të hartuara në atë mënyrë që më lehtë të vilesnin në kufi dhe me të vetmin qëllim mbushjen e buxhetit të konsoliduar të Kosovës. Ndërsa evazoni fiskal dhe hyrja e mallrave kontrabandë në mungesë të rregullatives ligjore si dhe rrespektimi i njëanshëm i marrëveshjeve të nënshkruara nga ish-Jugosllavia për marrëveshjet tregtare, ndikonte ndjeshëm në buxhetin e Kosovës<sup>37</sup>.

---

<sup>35</sup> Komoni S, (2008). Financat Publike Fq. 130

<sup>36</sup> ATK, (2007), Doracak mbi të tatimet në Kosovë fq. 9

<sup>37</sup> Komoni S, (2008). Financat Publike Fq. 130

## ***Kapitulli 4***

### **5. TATIMI NË TË ARDHURA DHE LLOJET E TIJ**

#### **5.1. Tatimi në të ardhura**

Nëse shikohet ana e mbledhjes së tatimit, mënyra më ideale dhe më efikase është tatimi në të ardhura, pra në bazë të të ardhurave të realizuara vihen noramat tatimore dhe sipas literature mendohet se tatimi mbi të ardhura është më i drejti në mesin e tatimeve <sup>38</sup>. Koncepti i tatimit të të ardhurave është një risi dhe një presupozim moderne në disa gjëra: si në ekonominë e parave, në llogari të arsyeshme, në shpenzime, fitime dhe në shoqëri të rregullt.

Tatimi mbi të ardhurat është tatim i vetëm mbi të ardhurat e individëve (personave) apo biznesit (koorporatave ose subjekteve të tjera ligjore). Të ardhurat tatimore paraqiten me shkallë të ndryshme të incidencës tatimore të cilat mund të jenë progresive, proporcional ose regresiv. Tatimi mbi të ardhurat e kompanive, është quajtur shpesh një tatim i koorporatave (tatimi në të ardhurat e koorporatës) ose tatimi mbi fitimin. Tatimet individuale/personale të të ardhurave tatimore shpesh quhen të ardhurat totale të individit (me disa zbritje të lejuar)

---

<sup>38</sup> Agjensia Europiane për rindërtim 2006 Projekt për mbështetje ligjore, Tatimi mbi të ardhurat fq.2



## 5.2. Struktura e tatimeve në të ardhurat në Kosovë

Struktura e tatimeve e të ardhurave përbëhen nga tatimet siç janë :

- Tatimi i paragjykuar (Rregullorja 2000/29), që ka filluar të aplikohet me 1 Korrik të vitit 2000<sup>39</sup>.
- Tatimi mbi të ardhurat personale (Rregullorja 2002/4 dhe 2003/3) ka filluar të aplikohet me 1 Prill të vitit 2002. Ka tatuar vetëm një burim të të ardhurave të individit (të ardhurat nga punësimi) – Pagën<sup>40</sup>.
- Tatimi në fitim ( Rregullorja 2002/3)<sup>41</sup>.

Kjo strukturë fillestare e aplikimit të tatimit në të ardhura pësoi ndryshime, ku me struktura re tatimore Kosova nga 1 janari i vitit 2005 numri i tatimeve në të ardhura është zvogluar nga 3 (tre) në 2(dy) pra janë bërë reduktime. Ku tatimi i paragjykuar nuk mbetet tatim i ndarë dhe si i tillë nuk do të bëjë pjesë me në skemën tatimore të Kosovës ndërsa tatimi mbi fitim tani quhet tatimi në të ardhurat e përbashkëta (koorporatave)

---

<sup>39</sup> [http://www.atk-ks.org/Shqip/Rregullore/UploadedFiles/A\\_Procedurat\\_Tatimore/Rregullore\\_2002\\_3.pdf](http://www.atk-ks.org/Shqip/Rregullore/UploadedFiles/A_Procedurat_Tatimore/Rregullore_2002_3.pdf)

<sup>40</sup> [http://82.114.64.12/~mfe-ks/index2.php?option=com\\_content&do\\_pdf=1&id=86](http://82.114.64.12/~mfe-ks/index2.php?option=com_content&do_pdf=1&id=86)

<sup>41</sup> [http://www.atk-ks.org/Shqip/Rregullore/UploadedFiles/A\\_Procedurat\\_Tatimore/Rregullore\\_2002\\_3.pdf](http://www.atk-ks.org/Shqip/Rregullore/UploadedFiles/A_Procedurat_Tatimore/Rregullore_2002_3.pdf)

### 5.3.Tatimi në te ardhurat personale

Tatimi në të ardhurat personale në Kosovë ka filluar të aplikohet nga 1 prilli i vitit 2002 dhe deri në fund të vitit 2004 që është aplikuar vetem në paga. Ndërsa me reformimin e sistemit tatimor më 1 janar të vitit 2005 hynë në fuqi skema e re tatimore sipas Rregullore Nr. 2004/52 “ Mbi tatimet në të ardhura personale”<sup>42</sup>. Sipas kësaj rregulloreje tatimi në të ardhura personale ka filluar të zgjerohet duke përfshirë të gjitha burimet e të ardhurave personale/ individuale. Më heret tatimi në paga është paguar vetëm nga pagat e të punësuarve kurse tani tatimi në të ardhurat personale përfshin të gjitha burimet e të ardhurave bruto që realizohen nga individët<sup>43</sup>.

Tatimi mbi te ardhurat personale, është ky lloj tatimi gjithëpërfshirës dhe që do të tatimohet si :

- Pagat
- Te ardhurat nga aktivitetet biznesore
  - Dividentat
  - Interesat
  - Qiratë
  - Fitimet nga lojërat e fatit
  - Fitimet nga të drejtat e autorit
  - Pensionet
  - Fitimet/humbjet kapitale (1 Janar 2010)
  - Çdo të ardhur tjetër që rritet pasurinë neto te tatimpaguesit

---

<sup>42</sup> [http://www.atk-ks.org/Shqip/Rregullore/UploadedFiles/A\\_Procedurat\\_Tatimore/Rregullore\\_2004\\_52.pdf](http://www.atk-ks.org/Shqip/Rregullore/UploadedFiles/A_Procedurat_Tatimore/Rregullore_2004_52.pdf)

<sup>43</sup> Komoni S, (2008). Financat Publike Fq. 133

Tatimi në të ardhura personale është tatim i drejtëpërdrejt dhe të cilin tatimpaguesi apo obliguesi tatimor dhe nuk mund ta bartë tek personat tjerë. Obligues dhe pagues i këtij lloji të tatimit sipas ligjit, është personi i cili realizon të ardhuren nga të gjitha burimet<sup>44</sup>.

Obligues tatimor i tatimit në të ardhura personale është personi fizik i cili realizon të ardhura bruto nga të gjitha burimet siç mund të jenë: në paga, aktivitete afariste, qira shfrytëzimi i pronës, interesi dividenda, lotari, lojërat e fatit, pensione etj. Ndërsa si objekt tatimor janë të ardhurat që i realizon personi fizik (individ) të cilët janë të tatueshëm për obliguesin tatimor (tatimpaguesin).

Kemi dhe disa dallime në mes obliguesit tatimor që është vendas i Kosovës dhe tatimpaguesin që nuk është banor i Kosovës. Tatimpaguesi banor i Kosovës si objekt tatimi për të janë të gjitha burimet e të ardhurave të realizuara në vend si dhe burimet e të ardhurave të krijuara jashtë Kosovës. Ndërsa tatimpaguesi jobanor (individ jorezident) i Kosovës si objekt tatimi është pjesa e të ardhurave të cilat e kanë burimin në Kosovë<sup>45</sup>.

Poashtu për tatimin në të ardhura personale janë paraparë dhe zbritje për shpenzimet e tatimpaguesve nga e ardhura bruto, ku këto shpenzime tatimpaguesi sipas ligjit për tatimin mbi të ardhura personale duhet t'i argumentojë me dokumente zyrtare, pasi që në mënyrë tjetër nuk do të lejohet zbritja e shpenzimeve, ku si fatura zyrtare të cilat tatimpaguesi mund të paraqet për lejjimin e zbritshëm janë: faturat, deklarata doganore, dëftesa, biletat, dokumentet e blerjes etj.

---

<sup>44</sup> ATK, (2007), Doracak mbi të tatimet në Kosovë fq. 15

<sup>45</sup> Komoni S, (2008). Financat Publike Fq. 130

### 5.3.1 Tatimi në paga ( të ardhurat nga pagat)

Tatimi në pagë është njëri nga tatimet e para të tatimit në të ardhura personale, i cili aplikohet nga 1 prilli i 2002 në të ardhura personale bruto nga të punësuarit për një periudhë të caktuar. Tatimpaguesit janë individët të cilët realizojnë të ardhurat bruto në pagat nga marrdhëniet e punës. Pra, sipas rregullores për tatimin mbi të ardhurat personale tatimpaguesit janë personat fizike, banorë dhe jobanorë të cilët krijojnë të ardhura bruto. Të ardhurat bruto nga pagat nënkupton kompensimin financiar dhe lloje tjera të kompensimit, përfshirë mallërat, shpërblimet, perfitimet në natyrë.

- **Objekt i tatimit** - për tatimpaguesin banor janë të ardhurat e tashme nga burimi i të ardhurave nga Kosova dhe burimi i të ardhurave nga jashtë.
- **Objekt i tatimit** - për tatimpaguesin jo banor janë të ardhurat e tashme ato që e kanë burimin në Kosovë<sup>46</sup>.

#### **Kush është punëdhënës e kush i punësuar**

“ I punësuar “do të thotë person fizik , i cili kryen punë për pagë nën drejtimin dhe kontrollin e punëdhënësit. Shprehja punonjës, i përfshinë të gjithë zyrtarët publik dhe pjesëtarët e organeve ligjvënëse, ekzekutive dhe gjyqësore lidhje me punësimin. Pra, i punësuar pavarësisht nëse punon për një ose më shumë punëdhës do të caktojë një punëdhënës kryesor.

Llogarit e tatimit sipas shkallëve progresive për punonjsin primarë 0%. 5%, 10%, 20% mbi grupet e të ardhurave si në vijim:

---

<sup>46</sup> ATK [http://www.atk-ks.org/shqip/Lajme/fajllat/Doracak\\_Janar\\_2007.pdf](http://www.atk-ks.org/shqip/Lajme/fajllat/Doracak_Janar_2007.pdf)

<b>Të ardhurat e tatueshme</b>		<b>Shkalla tatimore</b>	<b>Tatimi</b>
Të ardhurat e tatueshme	0-960 euro	0%	0 euro
Të ardhurat e tatueshme	960.01-3,000 euro	5%	102 euro
Të ardhurat e tatueshme	3,000.01-5,400 euro	10%	240 euro
Të ardhurat e tatueshme	5,400.01-6,400 euro	20%	200 euro

Punëdhënësi sekondar – Sipas shkallës maksimale 10%

**Pagimi** : Dorëzimi i pasqyres mujore të tatimit të mbajtur në burim (me ose deri në ditën e 15 –të muajit vijues )

### **5.3.2.1. Kontribute pensionale për të punësuarit Rreg.2001/35**

- Çdo punëdhënës është i obliguar të kontribuojë minimalisht 5% mbi pagën bruto, ndërsa në bazë vullnetare +10%
- Çdo i punësuar është i obliguar minimalisht të kontribuojë 5% nga paga e tij bruto, ndërsa në bazë Vullnetare +10%

KP. Minimal 5% + 5%=10%

KP. Maksimal 15% +15%=30%

### **5.3.2.2 Kontributet Pensionale për të Vetëpunësuarit**

Tatimpagues (të vetëpunësuarit) me të ardhura bruto më pak se 5000 euro për tre muaj duhet të kontribuojnë për kursime pensionale shumë prej: 23.40 Euro për një tremujor (78 Euro x 3 muaj =234,00x10%=23,40)

Tatimpagues me të ardhura bruto prej: 5000 - 50 000 (metoda e paragjykuar paguajnë kontribut 1/3 e tatimit, Max. 600)

Tatimpagues me të ardhura bruto mbi 50 000 Euro taten në fitimin real dhe ata që kanë zhgjedhur të taten në fitimin real duhet të kontribuojnë se paku, 1/10 e të ardhurave neto për çdo tremujor (max 600)<sup>47</sup>.

### **5.3.3.1 Të ardhurat nga aktivitetet biznesore**

Qarkullimi vjetor mbi 50 000 €, tatimi paguhet në bazë të fitimit. Për periudhën e parë tatimore këstet paradhënje të tatimit paguhet bazuar në parashikimin e të fitimit vjetor /4 Për periudhën e dytë dhe periudhat pasuese tatimpaguesi paguan 110% /4 të periudhës paraprake. Shkallet tatimore 0, 5, 10 dhe 20 % e fitimit të tatueshme

**Pagimi:** Dorëzimi i pasqyres për veprimtarinë e biznesit për çdo tremujor kalendarik mbrenda 15 ditëve të mbylljes së tremujorit.

### **5.3.3.2 Të ardhurat nga aktivitetet biznesore (bizneset individuale)**

Të ardhurat bruto nga veprimtaritë biznesore përfshijnë arkëtimet bruto të gjeneruara nga një person fizik i angazhuar në veprimtari të tilla.

a) Qarkullimi vjetor nën 5.000 €, tatimi paguhet në mënyrë të paragjykuar dhe pagesa minimale tremujore është 37.5 € ( 5000 € x 3% = 150/4= 37.50 për çdo tre mujor)

b) Qarkullimi vjetor nga 5 000 € deri në 50 000 € :

- 3% në të ardhurat bruto për prodhuesit, shitësit me pakicë, tregtarët dhe veprimtaritë e ngjashme komerciale;
- 5% e të ardhurave bruto për ata që kryejnë shërbime

---

<sup>47</sup> <http://www.unmikonline.org/regulations/2001/RE%202001-35.pdf>

### 5.3.4 Tatimi i mbajtur në burim mbi interes

Tatimpaguesi i tatimit nga interesi (kamata) është personi i cili realizon të ardhura nga ky aktivitet. Aplikohet mbi individët rezident dhe jorezident. Paguesit e interesit (bankat) janë të obliguar të mbajnë në burim 20 % tatim. Momenti i lindjes së tatimit është momenti i maturimit të interesit pa marrë parasysh a paguhet apo i bashkangjitet pricipalit.

Të ardhurat bruto nga interesi përfshijnë:

- Interesin nga huatë e personave fizikë,
- Interesin nga fletobligacionet ose letrat tjera me vlerë të lëshuar nga institucionet publike dhe organizatat afariste.
- Interesi nga llogarit e kursimeve që sjellin interes, që mbahen në bankat dhe institucionet tjera financiare.
- Të ardhurat bruto nga interesi nuk e përfshijnë interesin (kamatën) nga mjetet e trustit të kursimeve pensionale në Kosovë dhe fondeve tjera pensionale.

**Pagimi:** Mbjatesit në burim të tatimit në interes duhet të dorëzojnë një pasqyre mujore të tatimit të mbajtur në burim (me ose deri në ditën e 15 –të të muajit vijues )

### 5.3.5 Tatimi i mbajtur në burim mbi dividendë

Tatimi në të ardhurat nga dividenda përfshijnë të ardhurat bruto nga dividenda dhe fitimi tjetër i shpërndarë për tatimpaguesin. Shpërdaresit e dividendë (kompanitë), autoritet publike, organizatat biznesore, bankat dhe institucionet financiare janë të obliguara të mbajnë në burim 20 % tatim të seciles pages së dividendes bruto. Aplikohet mbi individët rezident dhe jorezident. Ndërsa dividenta e fituar nga mjete e trustitë kursimeve pensionale në Kosovë nuk përfshihen të ardhurat bruto të dividendës.

**Pagimi:** Mbjatësit në burim të tatimit mbi dividendë duhet të dorëzojnë një pasqyrë mujore të tatimit të mbajtur në burim (me ose deri në ditën e 15 - të muajit vijues )

### **5.3.6. Pagesa e tatimit për qiratë**

Të ardhurat nga qiraja përfshijn të ardhurat e krijuara nga dhënja me qira e pasurisë së tundëshme dhe të patundëshme. Tatimi në të ardhura nga qiraja, pasuria e patundshme është formë e tatimit në të ardhura personale, e cila bazohet në dhënjen e pasurisë në shfrytëzim me qira. Pasuritë e palujtshme të dhëna për qira që janë : toka, ndërtesat, banesat, lokalet etj dhe pasuri të palujtshme janë : paisjet mjetet transportuese etj, janë objekt i tatimit për të ardhurat nga qiraja. Ndërsa tatimpaguesi konsiderohet personi fizik i cili realizon të ardhurat nga qiraja, i cili është i obliguar të paguajë tatimin prej qirasë çdo tre muaj në përqindje 20% pasi që të zbriten shpenzimet e mirëmbajtjes së objektit.

**Pagimi :** Tatimpaguesit të cilet marrin të ardhura nga qiraja duhet të kryejnë pagesen e tatimit për çdo **tremujor** kalendarik mbrenda 15 ditëve të mbylljes së tremujorit. Jointsividët (personat juridik) për qirate e paguara janë të obliguar ta ndalin tatimin në burim ( shkalla 16%) në baza mujore.

### **5.3. 6. Tatimi i mbajtur në burim mbi fitimet nga llotaria dhe lojërat e fatit**

Tatimi në të ardhurat nga llotaria ose nga fitimet në lojërat e fatit apo të ardhurat nga faljet e borxheve, ku të ardhurat bruto nga llotaria ose nga tatimet në lojërat e fatit duhet që të deklarohen në kohën kur është shpallur fituesi nga ana e organizatorit. Kjo aplikohet te individuals rezident dhe jorezident të cilët fitojnë çmime në llotari. Secili organizues i një llotarie apo loje të fatit do të mbajë tatimin në burim me shkallën 20 %.

**Pagimi:** Mbajtesit në burim të tatimit mbi fitimet nga lojërat e fatit duhet të dorezojnë një pasqyre mujore të tatimit të mbajtur në burim (me ose deri në ditën e 15 – të të muajit vijues ).



## **5.4. Të ardhura të përjashtuara nga tatimi mbi të ardhurat personale**

Sipas rregullores Nr. 2004/52 nga pagimi i tatimit në të ardhura personale janë të liruar apo përjashtuar të ardhurat personale. Pagat e marra nga të punësuarit e huaj në:

- Organizatat Ndërkombëtare (Qeveritare & Joqeveritare)
- Perfaqesi diplomatikë
- UN, KFOR
- Të ardhurat e stafit lokal të UN
- Kompensimi për dëmtim apo shkatërrim të pronës
- Kompensimi për trajtim dhe shpenzime shëndetësore

### **5.5.1. Shpenzimet e lejuara si të zbritshme nga aktivitetet biznesore**

Shpenzimet që drejtperdrejt, tërësisht dhe ekskluzivisht me kryrjen e veprimtarive të tilla.

Te gjitha shpenzimet duhet të jenë të dokumentuara, në dokumente zyrtare si në vijim:

- Faturat komerciale
- Deklaratat e doganës
- Dëftesat, biletat e fluturimit
- Çdo dokument tjetër valit që mbështet shpenzimet

### **5.5.2. Shpenzimet pjesërisht të lejuara si të zbritshme:**

- Shpenzimet e përfaqësimit 2% të qarkullimit total
- Kontributet bamirëse 5% të të ardhurave të tatueshme të llogaritur përpara se të jetë zbritur ky shpenzim
- Borgji i keq

### **5.5.3. Shpenzimet në pasuri themelore (amortizimi-metoda e tepricës rënëse)**

- Ndertesat 5%
- Automobilot, pajisjet e zyrës dhe kompjuterave 20 %
- Pasuri të tjera themelore 15%

### **5.5.4. Shpenzimet e pazbritshme nga aktivitetet biznesore**

Kosto e blerjes së tokës

Kostoja e blerjes se aseteve

Ndëshkimet dhe gjobat

TVSH- ja e zbriteshme

### **5.6.1. Obligimet për të mbajtur libra dhe regjistrime**

Tatimpaguesit të cilët kërkohet apo vendosin te paguajnë tatimin në bazë të gjendjes reale, duhet të mbajnë librat dhe regjistrimet ne vijim:

- Një liber të shitjes
- Një liber të blerjes
- Një liber të shpenzimeve
- Një llogari kapitale

Tatimpaguesit që paguajne tatim me metoden e paragjykuar

- Liber të blerjes
- Liber të shitjes

### **5.6.2. Obligimet e mbajtesve të tatimit në burim**

Dorëzimi i pasqyres përmbledhjese vjetore dhe listës pageseës vjetore ( deri 31 janar të vitit vijues). Mbajtësve të tatimit në burim nëse iu kërkohet duhet t'i pajisin tatimpaguesit me certifikaten e tatimit dhe kontributit të mbajtur në burim, autoritete publike, organizatat biznesore dhe bankat e që bëjnë pagesa të interesit, dividendave dhe fitoreve në lotari duhet të dorëzojnë në ATK, sipas ligjeslacionit Ligji Nr. 03/L-115<sup>48</sup>.

### **5.7. Deklarata tatimore vjetore**

Tatimpagesit, të cilët fitojnë apo llogarisin të ardhura vetëm prej një ose më shumë burimeve vijuese, nuk u kërkohet të dorëzojnë deklarate vjetore përveç atyre që kanë diferencë pozitive apo negative të tatimit të obliguar.

- Pagat nga punëdhënësit kryesor
- Të ardhurat e biznesit kur tatimi është paguar në mënyrë të paragjykuar (qarkullimi nën 50.000 euro)
- Qiraja, kur zbritja prej 20% është bërë konform rregullores së tatimit mbi të ardhurat personale
- Interesi
- Dividentat
- Pagesat e anuiteteve pensionale
- Pagesat e fitimeve nga lojrat e fatit<sup>49</sup>.

---

<sup>48</sup> [http://www.atk-ks.org/Shqip/Tatimet/fajllat/tap/ru/Ligji\\_Nr\\_03L\\_115\\_TAP.pdf](http://www.atk-ks.org/Shqip/Tatimet/fajllat/tap/ru/Ligji_Nr_03L_115_TAP.pdf)

<sup>49</sup> Po aty.

## Kapitulli 5

### 6. TË HYRAT BUXHETORE NGA FITIMI NË TË ARDHURA (2003-2008 DHE REFORMAT E FUNDIT TË 2009-SË)

Në bazë të të dhënave buxhetore nga viti 2002 e deri më 2008 , do të mund të shohim përqindjen të cilën buxheti i Kosovës ka realizuar fitimet e tij gjatë kësaj periudhe kohore nga të hyrat tatimore nga tatimi në të ardhura personale.

Të ardhurat personale në vite	% E tatimit në të ardhura personale në buxhetin e Kosovës
2002	5.10 %
2003	9.90%
2004	17.69%
2005	28.00%
2006	<b>22.00%</b>
2007	16.70%
2008	18.49%

Tabela 1.0. Tek kjo tabelë paraqitet krahasimi nga viti 2002 dhe deri më 2008 e pjesëmarrjes së përqindjes së tatimit në të ardhura personale në të hyrat e buxhetit të Kosovës<sup>50</sup>.

Në tabelën sipër vërejmë me kujdes që në vitin 2002 kemi përqindje të ulët pjesëmarrëse të këtij lloji tatimi me 5.10% dhe që gradualisht kalon në rritje, pastaj shohim në vitin 2006 me 22.00%. Kjo përqindje fillon të pësojë rënie të vazhdueshme për dy vite radhas, mirëpo në viti 2008 kemi ngritje graduale, të pjesëmarrjes së tatimit në të ardhura personale në buxhetin e Kosovës<sup>51</sup>.

<sup>50</sup> MFE, <http://mef-rks.org/download/raportet-e-buxhetit-dhe-pasqyrat-financiare>

<sup>51</sup> Po aty.

## 6.1. Struktura e të hyrave nga Administrata Tatimore në gjashtëmujorin e 2009-së

Në këtë vitë sistemi tatimor i Kosovës ka psuar reformë në brendinë tij në ndrrimin e normave tatimore për të reflektuar si sistem më efikas në vend. Reformimi i normave tatimore në të ardhura personale janë bërë sipas ligjit për tatiminin mbi të ardhurat personale që reflektojnë me një normë më të ultë në bazat e njejtë tatimore siç janë:

Fitimi i tatueshëm për një Vitë	Shkalla e mëhershme e tatimit e shprehur në %	Ulja e shkallëve tatimore në të ardhmen e shprehur në %
0 deri 960	0%	0%
960 deri 3000	5%	4%
3000 deri 5400	10%	8%
Mbi 5400	20%	10%

Tabela 1.2. Paraqet ndrrimin e normave tatimore në të ardhura personale<sup>52</sup>.

Gjithashtu, ulen edhe normat e tatimit në dividendë, interes, qira, lojëra të fatit , fitime kapitale, shitjen e pasurisë së paprekshme etj, nga 20% në 10%, ndërsa tatimi i mbajtur në burim mbi qiratë e paguara nga 16% është zbritur në 9%. Ndërsa norma e tatimit në të ardhura të korporatave është zbritur nga nga 20% në 10%, kurse TVSH-ja është rritur për 1% pra nga 15% që ishte në 16%<sup>53</sup>.

Të hyrat e realizuara për periudhën Janar-Qershor 2009 janë 97.1 milion Euro, për 15.6 milion Euro ose 19% më shumë se sa plani i paraparë për këtë periudhë në vlerë prej 81.4 milion euro. Në të hyrat sipas llojeve të tatimeve pjesëmarrje më të madhe kanë të hyrat

<sup>52</sup> ATK, 2009 [http://www.atk-](http://www.atk-ks.org/Shqip/Dokumentet/UploadedFiles/A_Procedurat_Tatimore/Udhz_ndryshimi_normave_Tatimore_TA)

ks.org/Shqip/Dokumentet/UploadedFiles/A\_Procedurat\_Tatimore/Udhz\_ndryshimi\_normave\_Tatimore\_TA P.pdf

<sup>53</sup> Po aty.

nga TVSH-ja me 32%, tatimi në korporata me 30%, tatimi i mbajtur në burim me 18%, tatimi për bizneset Individuale 11%. Pasqyra mujore e mbajtjes në burim dhe pagesës së tatimit në interes, dividendë, të drejta pronësore, qira, fitore në lotari dhe lojëra të fatit 6%, tatimi i paragjykuar 2% dhe tatimi në fitim 1%.

Tatimi shtesë gjatë këtij gjashtëmujori, si rezultat i kontrollit tatimor dhe vlerësimeve nga ATK është 20,727,982 €, ku sipas llojeve të tatimeve pjesëmarrje më të madhe ka TVSH-ja me 33.8%, tatimi për bizneset e mëdha individuale 23.1%, tatimi në fitim dhe tatimi në korporata me 18.1%, kontributet e pensioneve 9.2%, tatimin në qira 7.1%, tatimi në paga 4.1%, tatimi për bizneset e vogla individuale 2.5%, tatimin e paragjykuar 1.6%, dhe tatimin në interes, lojëra te fatit 0.6%<sup>54</sup>.

Grafiku 1.0 Grafiku na paraqet përqindjet e të hyrave të gjashtëmujorit të 2009 nga tatimet në Kosovë<sup>55</sup>.

Në krahasim me planin e paraparë për këtë gjashtëmujor janë realizuar 62%, kurse në krahasim me realizimin e gjashtëmujorit 2008 janë realizuar 50 % më tepër<sup>56</sup>.

---

<sup>54</sup> ATK & MFE (2009) Raporti i final i punës për periudhen Janar Qerrshor 2009, fq 3

<sup>55</sup> Po aty.

<sup>56</sup> ATK, 2009. <http://mef-rks.org/download/raportet-e-buxhetit-dhe-pasqyrat-financiare/1719-2009?lang=sq>

## 6.2. Krahasimi i normave tatimore ndermjet vendeve të rajonit

Nëse bëjmë një krahasim në lidhje me normat tatimore të cialt aplikohen me vendet rajonale të Kosovës do shikojmë variantet e normave ndremjet tyre, në mes shteteve si Shqipëria, Maqedonia, Mali i zi dhe Serbia.

### 6.2.1. Tatimi mbi të Ardhurat në Shqipëri

TATIMI MBI TË ARDHUREN PERSONALE			
Mbi (në Lekë)	Deri (në Lekë)	Lekë	Përqindje
0	14 000		Pragu përjashtues
14 000 +	30 000	0	+ 5 % të shumës mbi 14 000
30 000 +	60 000	800	+ 10 % të shumës mbi 30 000
60 000 +	80 000	3 800	+ 15 % të shumës mbi 60 000
80 000 +	100 000	6 800	+ 18 % të shumës mbi 80 000
100 000 +	125 000	10 400	+ 20 % të shumës mbi 100 000
125 000 +	150 000	15 400	+ 23 % të shumës mbi 125 000
150 000 +	Më tepër	21 150	+ 25 % të shumës mbi 150 000

Tabela 1.3. Paraqet tatimin në të ardhura personale në sistemin tatimor në Shqipëri, me bazat tatimore dhe normat progresive tatimore<sup>57</sup>.

Dividentat, të ardhurat që rrjedhin si fitim i ortakut, qoftë ky ortak i vetëm, interesat nga huatë, depozitat ose kontratat e ngjashme, të ardhurat nga e drejta e autorit ose pronësia intelektuale, qeratë apo të ardhura nga kontrata të tjera të ngjashme (huapërdorja) dhe të ardhura të tjera taten 10 %, ndërsa të ardhurat nga lojërat e fatit taten me 20%<sup>58</sup>.

<sup>57</sup> ALBIC, 2009. <http://www.albic.net/Shqip/InfoBiznesi/SistemiFiskal/Taksat/taksguide05-K03.htm>

<sup>58</sup> Po aty.

## 6.2.2. Tatimi mbi të ardhurat në Mal të Zi

Normave të tatimit mbi të ardhurat personale në Mal të Zi janë progresive. Përfshirjet janë dhënë për taksapaguesit me lloje të veçanta të të ardhurave.

Ardhurat (mujore)	tatueshëm	Tatimi për t'u paguar
deri në 65 Euro		0%
65-218 Euro		0 euro + 16% nga të ardhurat që tejkalon 65 Euro
218-381 Euro		24,40 euro + 20% nga të ardhurat që tejkalon 218 Euro
mbi 381 Euro		57 euro + 24% nga të ardhurat që tejkalon 381 Euro

Tabela 1.4. Paraqet tatimin në të ardhura personale të sistemit tatimor në Malin e zi<sup>59</sup>

## 6.2.3 .Tatimi mbi të ardhurat në Serbi

- Të ardhurat për një individ është e tatueshme në normën prej 14%-20%
- Norma standarde e tatimit për një korporatë është 10%.

## 6.2.4. Tatimi mbi të ardhurat në Maqedoni

Të ardhurat për një individ është e tatueshme në normën prej 15%, 18% dhe 24% pra me norma progresive. Ndërsa norma standarde e tatimit për një korporatë është 10%.

Nëse i shikojmë normat tatimore të këtyre vendeve rajonale do ta vëmë re se këto vende kanë normat tatimore në të ardhura më të larta në krahasim me vendin tonë. Pra, mund të themi se Kosova posedon tashmë normat më të ulta të tatimit në të ardhura në rajon <sup>60</sup>.

<sup>59</sup> [http://www.worldwide-tax.com/serbia\\_montenegro/montenegro\\_tax.asp](http://www.worldwide-tax.com/serbia_montenegro/montenegro_tax.asp) ,

<sup>60</sup> <http://www.worldwide-tax.com/> 2009



## 7. METODOLOGJIA

Studimi ka për qëllim të nxjerrë në pah rolin dhe zhvillimin e sistemit tatimor në Kosovë, duke analizuar faktorët ndihmës si: politikën ekonomike, politikën fiskale, në mënyrë relevante ndikimi i tyre në sistemin tatimor dhe në veçanti për tatimin në të ardhura personale, si dhe efektet dhe ndikimi i tatimit në bizneset e ndryshme në Kosovë, që ishte e përmbledhur në një mostër relativisht të vogël hulumtimi. Instrumenti hulumtues ishte pyetësoi, trajtuar në mënyrë shumë kofidenciale duke siguruar të intervistuarit se pyetësori do të përdoret për studime universitare në “Universitetin për Biznes dhe Teknologji” UBT, me informata shtesë mbi tutorin e lëndës dhe me e-mail kontaktues, në mënyrë që ky pyetësor të ishte i besueshëm për të intervistuarin.

Pyetësoret përmbanin intervistë gjysëm të strukturuar, me temë diskutimi sistemin tatimor me dhjetë pyetje relevante përmbledhëse. Mostra studiuuese ishte e limituara për arsye të kohës së pamjaftueshme, për të zgjeruar studimin në më shumë të intervistuar, mirëpo me këtë mostër kemi qenë sado pak në gjëndje të kuptojmë aspektin e përpilimit të pyetësorve dhe intervistimit, në mënyrë konkrete se si të bëhet një hulumtim.

## 8. ANALIZA E TË DHËNAVE

Qëllimi i intervistimit për këtë studim, ishte që ne të kuptojmë se sa është i rëndësishëm sistemi tatimor në ndërmarrje dhe tek individit i ndërmarrjes dhe se cili ishte roli dhe zhvillimi i tij. Mbledhja e të dhënave ka qenë e thjeshtë pasi mostra ishte e relativisht e vogël nga 10 të intervistuar. Për të analizuar të dhënat në mënyrë sa më të efektshme të mundshme dhe kualitative që do preknin aktualitetin e sistemit tatimor, si me përparësitë dhe mangësitë e tij.

Mbledhja e të dhënave është bërë përmes pyetësorve, siç e kemi shtjelluar dhe tek metodologjia dhe ky lloj anketimi ishte krijuar në kontakt të drejtpërdrejtë me të intervistuarit dhe përmes postës elektronike me e-mail tek të intervistuarit, me dhjetë pyetje gjysmë të strukturuar, përsonat e përzgjedhur nga mostra relevante ishin: pronar, menaxher, financier dhe kontabilist kompanie në Kosovë<sup>61</sup>. Dizajnimi i pyetësorit ishte përpiluar në atë mënyrë që të jap kuptim real dhe të prekshëm nga natyra praktike e pikëpamjes së bizneseve mbi sistemin tatimor, duke ardhur në përfundim me daljen në pah të temave kyçe nga ky analizim i të dhënave siç janë:

1. Tatimet e larta në të ardhura në nivelin e standartit të të ardhurave në Kosovë zvogëlojnë fuqinë blerëse
2. Reformat e fundit në sistemin tatimor rezultojnë të jenë më favorizuese tek bizneset

Nëse i shikojmë që në fillim temën e parë që ka nxjerr hulumtimi apo ka dalur nga ky hulumtim, vihen re se është pjesë e mangësive të sistemit tatimor që është pengesë dhe jo favorizuese për të dhënë mundësi zhvillimi afarizmit biznesor të vendit, e gjithë kjo është rezultat i një politike financiare jo efikase. Mirëpo vërehet se me aplikimin reformave apo me zvoglimin e normave tatimore si përparsi bizneset janë më të liruar nga tatimet ku

---

<sup>61</sup> Pyetësoret janë të paraqitur në fund në shkojcën 2.

vlen të theksohen si: tatimi në fitim, tatimi në të ardhura, tatimi në korporata. Një shenjë favorizuese e sistemit tatimor reflekton ulja e normave tatimore që na e kanë pohuar edhe të intervistuarit. Megjithatë vërejmë se një ndër llojet e tatimit siç është TVSh-ja reflekton që po bëhet tatimi më i padëshiruari për tu paguar dhe po ashtu kjo vihet më shumë në diskutim me rritjen e normës së TVSH-së në reformat e fundit.

### **8.1. Tatimet e larta në të ardhura në nivelin e standardit të të ardhurave në Kosovë zvogëlojnë fuqinë blerëse**

Në radhë të parë studimi sqaron dy versione që kanë të bëjnë me fuqinë blerëse që pastaj të kemi mundësi të konkludojmë se cila do të ishte alternativa më e mirë e mundshme. Version i parë: nëse të ardhurat janë të vogla për individ, ai nuk do të ketë mundësi të blejë shumë gjëra, vetëm ato esenciale dhe nuk do mund të kursente, ku nga literatura thuhet se kursimet janë pjesë e investimeve që d.m.th nëse kemi kursime nesër mund të investojmë dhe investimi gjeneron të hyra (të ardhura) e cila në realitet realizohet si proces zingjiror . Ndërsa në versionin tjetër thuhet se nëse e ardhura është e vogël, individët nuk mund të blejnë dhe konsumojnë shumë produkte dhe menjëherë do të ndikonte në uljen e konsumit dhe qarkullimi i të hyrave do të jetë relativisht i vogël që ndikojnë direkt në mbledhjen e buxhetit shtetëror. Nga këtu mund të shtojmë se nëse të ardhurat janë të ulta dhe taksa e lartë kjo do të kishte ndikime negative në produktin e brendshëm bruto PBB, ku do të rezultonin me uljen në konsum dhe investime që janë dy faktor kyq të zhvillimit ekonomik të një vendi.

## **8.2. Reformat e fundit në sistemin tatimor rezultojnë të jenë më favorizuese tek bizneset**

Shpjegimin më të arsyeshëm tek kjo temë e studimit do t'i jepnin reformat e fundit të sistemit tatimor të po këtij viti '09 me uljen e normave tatimore, ku nga këtu reflekton ulja e tatimit në të ardhura personale nga normat në 0%, 5%, 10%, 20, janë ulur në 0%, 4%, 8%, 10%. Mirëpo këtu studimi thekson se përfitues nga ky reformim janë individët me pagat e larta ku norma tatimore ishte nga 20% në 10%, pra me 10% diferenc ulje në tatim, që kjo nuk është aq favorizuese tek nivelet tjera tatimore tek ato me 10% në 8% me diferencë zbritje 2% si dhe 5% në 4% me një zbritje të vogël diferencë me 1%. Fundja ulja e këtyre normave tatimore tek individët e punësuar është sa do pak motivuese dhe favorizuese se mund të kenë ngritje me përqindje të vogël të të hyrave të tyre dhe ju rritet fuqia blerëse dhe të konsumojnë më shumë të mira materiale dhe të kontribuojnë në rritjen e përqindjes PBB së Kosovës. Përveç reformave të këtij lloj tatimi studimi vë në pah dhe uljen e normave tatimore dhe tek tatimi në fitim që ishte 20% dhe kemi zbritje në 10% është shumë favorizuese biznesi përfiton nga ky ndryshim i normës në tatimore, duke iu krijuar mundësi të reja bizneseve për investime të reja<sup>62</sup>. Mund të cekim një përgjigje nga të intervistuari i cili citon :” Për fuqinë punëtore është me e favorshme që edhe biznesi përfiton në këtë ulje dhe mendoj se edhe qeveria përfiton për arsye se bizneset kanë mundësi më të madhe për investime të reja dhe kuptohet pastaj me zvillimin e bizneseve dhe rritjen e fitimeve rriten edhe detyrimet ndaj shtetit “.

---

<sup>62</sup> [http://www.atk-ks.org/Shqip/Dokumentet/UploadedFiles/A\\_Procedurat\\_Tatimore/Udhz\\_ndryshimi\\_normave\\_Tatimore\\_TAP.pdf](http://www.atk-ks.org/Shqip/Dokumentet/UploadedFiles/A_Procedurat_Tatimore/Udhz_ndryshimi_normave_Tatimore_TAP.pdf)

## 9. PËRMBLEDHJA

Qëllimi i këtij studimi ishte që të kuptojmë rëndësinë dhe rolin e sistemit tatimor, në mënyrë më të detajizuar ndërtimin e sistemit tatimor në periudhën e pasluftës dhe tatimin në të ardhura personale në Kosovë, duke analizuar se çfarë shkruan literatura për politikën fiskale, sistemin tatimor si dhe se si ndikojnë biznesin afarist dhe në zhvillimin ekonomik të vendit.

Në bazë të gjithë këtij studimi vijmë me një përmbledhje se politika fiskale luan një rol kyq në zëvillimin e politikës ekonomike si bazë mbështetëse e ekonomisë së një vendi dhe e cila drejtohet nga bartësit e kësaj ekonomie që janë organet qeveritare – qendrore, të cilët hartojnë analiza për nevoja të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave dhe të vetë Qeverisë për të mundësuar një rishpërndarje më optimale buxhetore por dhe për të siguruar të hyra të nevojshme buxhetore me një shpërndarje minimale të aktivitetit ekonomik. Mirëpo për realizimin e politikës fiskale kemi sistemin tatimor që na ndihmon në mbushjen e buxhetit konsolidues të shtetit, ku çdo ditë e më tepër po ndihet suksesti i saj dhe një tentativë e mirë e krijimit të politikës tatimore që po bëhet dominuesja më e madhe në mbushjen e arkës shtetërore.

Në bazë të literatures e vërejtëm se tatimet në një mënyrë po mblidhen me forcë nga shteti për plotësimin e nevojave financiare publike apo për përmbushjen e nevojave qeveritare të një vendi. Pra, tatimet në botën bashkohore janë të hyra të pakthyeshme, derivative dhe mblidhen me forcë për interes publik dhe për të cilat shteti nuk jep kompenzim të drejtpërdrejt e cila për nga pikëpamja është njësoj dhe praktikohet sot edhe në Kosovë.

Mirëpo duke eksploruar studimin nga këndvështrimi i bizneseve afariste duke analizuar të dhënat nga hulumtimi me pyetësor tek temat të cilat kanë dalur në pah janë vërejtur mangësitë e funksionimit të politikave fiskale në strategjinë e saj si instrumenti më i rëndësishëm i politikës ekonomike. Megjithatë përmes këtij studimi me anë të pyetësorve

vërejmë se temat të cilat kanë dalur vlen të cekën reformat në normat tatimore në tatimin e të ardhurave personale që janë mirëpritur si pjesë favorizuese e të të punësuarve që të kenë ngarkesë më të ulët tatimore.

Ndërsa nëse shikohet nga ana e mbledhjes së tatimit mënyra më ideale dhe efikase është tatimi në të ardhura, pra nga këtu mësojmë se në bazë të të ardhurës së realizuar vëhet norma tatimore dhe mendohet se tatimi mbi të ardhura është më i drejti në mesin e tatimeve.

Përfitues nga ky studim në radhë të parë jemi ne studentët të cilët realisht informohemi me zhvillimin e politikës fiskale dhe të ndikimit të sistemit tatimor, respektivisht se si funksionon sistemi tatimor me përparësitë dhe mangësitë e tij. Përfitues më të mëdhenjë janë bizneset afariste që janë aplikues të tatimeve, po ashtu që këto biznese të jenë në hapa me zhvillimin e politikës fiskale dhe të përfitojnë nga reformat tatimore, si dhe organet qeveritare që të hartojnë politika më favorizuese për të ngritur nivelin e zhvillimit ekonomik të vendit. Po ashtu përfitues nga ky studim është dhe universiteti i cili grumbullon material studiues mbi aktualitetin e sistemit tatimor të Kosovës. Mbi të gjithë këta përfitues që cekëm vlenë të thuhet se të gjithë qytetarët përmes tatimit e ngrisin mirëqenien e tyre të të jetuarit.

## 10. KONKLUZA

Në bazë të shqyrtimit të literaturës dhe analizimit të të dhënave mbi bizneset në Kosovë për realizimin e temës “Sistemi tatimor dhe tatimi në të ardhura personale” vijmë në konkluzion se në ndërtimin e një sistemi të mirfilltë dhe funksional në Kosovë, së pari duhet t`i hedhim një vështrim se si janë të rregulluara politikat ekonomike të një vendi. Vërejmë se politika fiskale është instrument i politikës ekonomike ku përmes saj shteti mund të ndërhyj në rrjedha ekonomike, me arsyetimet në rregullimet e bëra në drejtim të mënjanimin të dukurive që bëhen pengesë për ruajtjen e mirëqenies së përgjithshme të shoqërisë.

Poashtu konkludojmë se shteti ka qasje në ndryshimin e politikës fiskale e cila është hartuese e politikave të sistemit tatimor, në një mënyrë vihet në pah shumë shpejt se tatimet janë të hyra qeveritare të cilat mbildhen me forcë nga shteti për t`i plotësuar nevojat e tij financiare. Literatura e pohonte se tatimet mbildhen me forcë ato nuk paguhen me dëshirë po që janë të obliguar detyruesit tatimor të paguajnë, të nejtën gjë e mbështesin dhe bizneset afariste .

Në analizimin e të dhënave, studimi ka vënë re se nga bizneset e intervistuar paguajnë tatimet në mënyrë të rregullt sipas rregulloreve nga ATK-ja, por që nuk hezitojnë të theksojnë se përveç reformave të fundit në sistemin tatimor që ishin mjaft favorizuese për bizneset, theksojnë se se rritja e TVSH-së ju duket e lartë dhe njëra ndër llojet që nuk dëshironin ta paguanin.

Megjithatë, politika e sistemit tatimor e reformuar ka si synim shtrirjen e sistemit tatimor në mënyrë sa më të gjerë, të këtë shumëllojshmëri në tatime që mos të jetë shumë rënd për tatimpaguesit . Synim tjetër është që përmes uljes së normave tatimore si p.sh normat në tatimin në të ardhura personale, tatimin në fitim etj. në një mënyrë t`iu lejojë kesh-in më

shumë dhe të rris konsumin, duke e ngritur normën e TVSH-në mënyrë për të siguruar mbledhje më të shpejt të dhe më të lehtë të të hyrave buxhetore, pasi që TVSH-ja paguhet direkt në konsum.

Mirëpo në një mënyrë tatimet është mirë të jenë sa më reale dhe më të shpërndara në mënyrë horizontale dhe të jenë të vendosura në normat e duhura që obliguesi tatimor të jetë i aftë t'i paguajë pa dëmtuar rënd ekonomikisht. Me pagimin e detyrimeve tatimore njëkohësisht po kontribuojmë në ndërtiin e shtatit, si dhe krijumin e standarteve më të mira jetësore.



## 11. LITERATURA / REFERENCAT

- Komoni, S. (2008). Financat Publike , Prishtinë, Fakulteti ekonomik 2008. 2009
- Braishori, B. (2008). Taxation. Prishtinë 2008, Universiteti Per Biznes dhe Teknologji 2009
- Hallett, A. Hagen, J. Lewis, J (2003). Fiscal policy in Europe, 1991-2003: an evidence-based analysis Centre for Economic Policy Research (Great Britain), Evidence Network (Organization) . Centre for Economic Policy Research, 2009
- Annett, A (2006) Enforcement and the Stability and Growth Pact: How Fiscal Policy Did and Did Not Change Under Europe’s Fiscal Framework. International Monetary Fund European Department. 2009
- Roosevelt, F (2007) 2009 <http://www.quotegarden.com/taxes.html>
- Holmes, O (2007) 2009 <http://www.governmentisgood.com/articles.php?aid=17>
- Administrata Tatimore e Kosovës ATK, & Ministria e Ekonomis dhe Financave MEF, (2009). Udhëzues për mënyrën e aplikimit të normave të reja. 2009 [http://www.atk-ks.org/Shqip/Dokumentet/UploadedFiles/A\\_Procedurat\\_Tatimore/Udhz\\_ndryshimi\\_normave\\_Tatimore\\_TAP.pdf](http://www.atk-ks.org/Shqip/Dokumentet/UploadedFiles/A_Procedurat_Tatimore/Udhz_ndryshimi_normave_Tatimore_TAP.pdf)
- UNMIK (2002) Rregullorja Nr. 2002/3. Mbi Tatimin në fitim në Kosovë Prishtinë 2009. [http://www.atk-ks.org/Shqip/Rregullore/UploadedFiles/A\\_Procedurat\\_Tatimore/Rregullore\\_2002\\_3.pdf](http://www.atk-ks.org/Shqip/Rregullore/UploadedFiles/A_Procedurat_Tatimore/Rregullore_2002_3.pdf)
- MFE, (2008). Tatimi mbi të Ardhurat Personale, Prishtinë, 2009. [http://82.114.64.12/~mfe-ks/index2.php?option=com\\_content&do\\_pdf=1&id=86](http://82.114.64.12/~mfe-ks/index2.php?option=com_content&do_pdf=1&id=86)

- UNMIK, (2001). Regullorja Nr.2001/35 Mbi pensionet në Kosovë 2009. <http://www.unmikonline.org/regulations/2001/RE%202001-35.pdf>
- ATK, (2009) Tatimi mbi të ardhurat personale Prishtinë. 2009 ,<http://www.atk-ks.org/Shqip/Tatimet/default.asp?IDTatimiLloji=2>
- ATK, (2005) Doracak mbi tatimet në të ardhura personale, Prishtinë.2009 <http://www.atk-ks.org/Shqip/Tatimet/fajllat/tap/ru/Doracak.pdf>
- ATK, (2008). Ligji Nr. 03/L-115 Republika e Kosovës, 2009 [http://www.atk-ks.org/Shqip/Tatimet/fajllat/tap/ru/Ligji\\_Nr\\_03L\\_115\\_TAP.pdf](http://www.atk-ks.org/Shqip/Tatimet/fajllat/tap/ru/Ligji_Nr_03L_115_TAP.pdf)
- MFE, ATK, Republika e Kosovës, Qeveria e Kosovës, (2009). Tatimi në të ardhura personale – ulja e normave tatimore, Prishtinë 2009 [http://www.atk-ks.org/Shqip/Dokumentet/UploadedFiles/A\\_Procedurat\\_Tatimore/Udhz\\_ndryshimi\\_normave\\_Tatimore\\_TAP.pdf](http://www.atk-ks.org/Shqip/Dokumentet/UploadedFiles/A_Procedurat_Tatimore/Udhz_ndryshimi_normave_Tatimore_TAP.pdf)
- MFE (2009), Buxheti i Konsoliduar i Kosovës, Prishtinë 2009, <http://www.mfe-ks.org/old/Shqip/mefwww/departamentet/buxhetikk/bkk.html>
- MFE( 2003, 2004, 2005, 2006, 2007, 2008,) Raportet e Buxhetit dhe Pasqyrat Financiare, Prishtinë 2009. <http://mef-rks.org/sq/download/314-raportet-e-buxhetit-dhe-pasqyrat-financiare>
- Wikipedia, 2009 <http://en.wikipedia.org/wiki/Tax>
- Boglea, V. (2006), Some aspects regarding the structure of taxation system in the european union countries, 2009 <http://conferinta.uav.ro/files/conferinta-2008/47.pdf>
- MFE, 2009, [http://82.114.64.12/~mfe-ks/index.php?option=com\\_content&task=view&id=95&Itemid=133&lang=alb](http://82.114.64.12/~mfe-ks/index.php?option=com_content&task=view&id=95&Itemid=133&lang=alb)
- Infoarkiv, Burokracia politike dhe sistemi tatimor në Kosovë 2009 <http://lajme.shqiperia.com/html/media/artikull/iden/218133/titulli/Burokracia-politike-dhe-sistemi-tatimor-ne-Kosove>

- Banka Buric (2008), Montenegro Income Taxes and Tax Laws [http. 2009  
//www.worldwide-tax.com/serbia\\_montenegro/montenegro\\_tax.asp](http://www.worldwide-tax.com/serbia_montenegro/montenegro_tax.asp)
- World Taxes Income Tax Rates Tax Rates, 2009 <http://www.worldwide-tax.com/>
- AC, (2006), Without Taxes There Would Be No Money to Get Things Accomplished. 2009  
[http://www.associatedcontent.com/article/58978/what\\_are\\_taxes\\_and\\_why\\_do\\_they\\_exist.htm](http://www.associatedcontent.com/article/58978/what_are_taxes_and_why_do_they_exist.htm)
- ALBIC, 2009.  
<http://www.albic.net/Shqip/InfoBiznesi/SistemiFiskal/Taksat/taksguide05-K03.htm>

## Shtojc 1.

Normat tatimore t shteteve të ndryshme të botës (World-wide Tax , 2009)

Vendet	Tatimet në të ardhura		TVSH
	Korporat	Individ	
Argentina	35%	9-35%	21%
Australia	30%	17-45%	10% GST
<u>Austria</u>	25%	21%-50%	20%
<u>Brazil</u>	34%	7.5-27.5%	17-25%
<u>Bulgaria</u>	10%	10%	20%
<u>China</u>	25%	5-45%	17%
<u>Cyprus</u>	10%	20-30%	15%
<u>Czech Rep.</u>	20%	15%	19%
Denmark	25%	38-59%	25%
Egypt	20%	10-20%	10% gst
<u>Estonia</u>	21%	20%	20%
<u>Finland</u>	26%	7.0-30.5%	22%
France	33.33%	5.5-40%	19.6%
<u>Germany</u>	30-33% (effective)	14-45%	19%
<u>Greece</u>	25%	0-40%	19%
<u>Hungary</u>	16%	18% and 36%	25%
<u>India</u>	30-40%	10-30%	12.5%
<u>Italy</u>	31.4%	23%-43%	20%
<u>Japan</u>	30%	5-50%	5% (consump)

<u>Latvia</u>	15%	23%	21%
<u>Lithuania</u>	20%	15%/20%	19%
<u>Luxemburg</u>	21%	0-38%	15%
<u>Malta</u>	35%	15-35%	18%
<u>Mexico</u>	28%	0-28%	15%
<u>Monaco</u>	33.33%	0%	19.6%
<u>Montenegro</u>	9%	12%	17%
<u>Netherlands</u>	20-25.5%	0-52%	19%
<u>Poland</u>	19%	18%/32%	22%
<u>Portugal</u>	12.5/25%	0-42%	20%
<u>Romania</u>	16%	16%	19%
<u>Russia</u>	20%	13%	18%
<u>Saudi Arabia</u>	20%	20%	--
<u>Serbia</u>	10%	10-20%	18%
<u>Slovakia</u>	19%	19%	19%
<u>Slovenia</u>	21%	16%-41%	20%
<u>South Africa</u>	28%	0-40%	14%
<u>Spain</u>	30%	24-43%	16%
<u>Sweden</u>	26.3%	0-57%	25%
<u>Tunisia</u>	30%	15-35%	18%
<u>Turkey</u>	20%	15-35%	18%
<u>U.K.</u>	28%	0-40%	15%
<u>Ukraine</u>	25%	15%	20%
<u>U.S.A.</u>	15-35%	15-35%	-

## **Shtojc 2.**

Mostra e pyetsorit të përdorur si instrument hulumtues.

### **Hyrje**

Të nderuar Zonja dhe Zotërinj

Falemnderit që keni pranuar të merrni pjesë në hulumtimin që jam duke e kryer si pjesë të studimeve të mia në Kërkimet Hulumtuese pranë Universitetit për Biznes dhe Teknologji-Prishtinë. Ky studim ka të bëjë me atë se si organizatat dhe kompanitë kosovare paguajnë tatimet e tyre, me theks të vecantë ndërlidhja e tyre me tatimin në të ardhura.

Kjo intervistë nuk do të marr kohë më shumë se një orë dhe do të kryhet në prezencë të studentëve të cilët do të mbledhin shënimet që do të shfrytëzohen më tutje për analiza. Studenti do të propozoj kohën për intervistë duke patur në konsideratë kohën kur ju jeni në dispozicion



### **TË GJITHA PËRGJIGJET DO TË TRAJTOHEN ME NJË KONFIDENCIALITET TË LARTË**

Ky studim është duke u menaxhuar nën mbikqyrjen e Behxhet Brajshorit, ligjërues në lëndën Kërkimet Hulumtuese, në UBT ( mund të kontaktohet përmes emailit:

[bbrajshori@hotmail.com](mailto:bbrajshori@hotmail.com))

Për çfarëdo komenti apo pyetje ju lutem mos hezitoni të kontaktoni Universitetin për Biznes dhe Teknologji- Prishtinë.

Pyetsori lidhur me tatime

**Pjesa 1. Informata e përgjithshme**

1. Ju lutem prezentoni postin e juaj: \_\_\_\_\_
2. Emri i kompanise tuaj: \_\_\_\_\_
3. Emaili juaj \_\_\_\_\_
4. Lokaliteti ku jeni te vendosur: \_\_\_\_\_
5. Sa njerez keni te punesuar ne kompani? \_\_\_\_\_
6. Ju lutem të përshkruani shkurt natyrën e biznesit tuaj: \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_
7. Që sa kohë kompania juaj punon në këtë biznes? \_\_\_\_\_

## Pjesa 2. Pjesa për tatime

1. Në çfarë mënyre mund të ndikoj politika fiskale në zhvillimin e biznesit tuaj?

---

2. A mund të na spjegoni se si ndikon sistemi tatimor në afarizëmin e juaj?

---

3. A mendoni se sistemi tatimor mundë të jetë faktor në ngecjen e ngritjeve apo zhvillimin e bizneseve dhe Pse?

---

4. Cili nga llojet e tatimit është më i padëshiruesh për t`u paguar nga ana e juaj si biznes afarist dhe pse?

---

5. Si i paguni detyrimet tatimore të kompanis tuaj?

---

6. Si ndikojne tatimi ne te ardhura në biznesin tuaj?

---

7. A mendoni se normat tatimore të tatimit në të ardhura personale janë të arsyeshme ?

---

8. Si kanë ndikuar reformat e fundit tatimore në biznesin tuaj?

---

9. A mendoni që me ulja e norms tatimore në të ardhura personale është një lehtësim apo favorizim për vet biznesin apo për punëtoret dhe Pse?

---

10. A mendoni se me pagimin e tatimeve po kontriboni për ndërtimin e shtetin dhe cfar benefite merrni në pagimin e tatimeve?

---